

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5777
E mërkurë, 15 maj 2019
çmimi 0.40 €

Krërët e shtetit Kryerësit e masakrave në Kosovë do të dënohen

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

UÇIÇ E DËGJON FJALIMIN SHQIP NË PARLAMENT F.11



Ismet SYLEJMANI

KOSOVA KA PËRPARUAR NDJESHËM NË REDUKTIMIN E ARMËVE TË VOGLA DHE TË LEHTA F.10



Izmi ZEKA

TRUMPI SHTRON IFTAR NË SHTËPINË E BARDHË, ÇITAKU ULET PËRKRAH TIJ F.2

ISMET TEMAJ ZGJEDHET REKTOR I UNIVERSITETIT 'UKSHIN HOTI' F.10

EKONOMI

SI TË SHPËTOHET PTK-ja? F.10



Nga Jakup
KRASNIQI

SHALA: KOHA QË PROBLEMET E EKSPORTEVE TË KOSOVËS NË MAQEDONI TË ELIMINOHEN F.9

SPORT

LLAPI KËRKON FITORE PËR VEND TË DYTË, 'NIKLI' PËR TITULL F.12

KATËR SKUADRAT ELITARE TË HENDBOLLIT NË KËRKIM TË FINALES F.13

FLET PËR "EPOKËN E RE", ADRIJANA HOXHIQ F.4-5

Zgjedhjet në veri do të shkojnë mirë

Ministrja e Administrimit e Pushtetit Lokal, Adrijana Hoxhiq, beson se zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale në katër komunat veriore do të shkojnë mirë dhe pa ndonjë problem në terren. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se pret që procesi zgjedhor të jetë korrekt dhe demokratik. Hoxhiqi i ka ftuar të gjithë qytetarët e këtyre komunave veriore që të dalin në zgjedhjet e 19 majit dhe të votojnë sipas vullnetit të tyre. Sipas saj, institucionet kompetente i kanë marrë veprimet edhe në planin e sigurisë

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR TË MARTËN SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR
GJENDJEN NË TELEKOMIN E KOSOVËS F.8-9

Debat koti për Telekomin

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, e thirrur nga partitë opozitare, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, për gjendjen në Telekomin e Kosovës, ka përfunduar të martën pa ndonjë rezultat, pasi nuk ka arritur të dalë në votim rezoluta për Telekomin për shkak të mungesës së kuorumit. Për gjendjen në Telekomin e Kosovës, kompani kjo e cila ndodhet në prag të falimentimit, ka pasur akuza reciproke ndërmjet deputetëve të partive në pushtet dhe atyre të opozitës



Qeveria kërkon zbatim më të shpejtë të reformave për MSA-në F.7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO

Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Trumpi shtron iftar në Shtëpinë e Bardhë, Çitaku ulet përkrah tij

WASHINGTON, 14 MAJ (ER) - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka shtruar iftar në Shtëpinë e Bardhë. E pranishme në këtë iftar ka qenë edhe ambasadorja e Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, e cila ishte ulur përkrah presidentit Trump. Çitaku përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se ka pasur nderin dhe kënaqësinë e veçantë që në darkën e iftarit të shtruar në Shtëpinë e Bardhë të ishte ulur përkrah

presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald J. Trump. "Presidentit Trump i tregova se në shtetin tonë sekular ka një kulturë tolerance dhe harmoni ndërmjet religjioneve. Po ashtu, e njoftova hollësisht për sfidat me të cilat ballafaqohemi aktualisht në Kosovë dhe biseduam mbi domosdoshmërinë e përfshirjes së drejtpërdrejtë të ShBA-së në proceset e rëndësishme nëpër të cilat po kalon shteti ynë i ri", ka shkruar ambasadorja Çitaku.



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka mbajtur konferencë për medie

Haradinaj thotë se dialogu Kosovë - Serbi është në duar të sigurta

Procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë tani është në duar të sigurta. Kështu ka deklaruar të martën kryeministri Ramush Haradinaj në një konferencë me gazetarë. Ai ka thënë se tashmë ky proces i është hequr nga duart Federica Mogherinit prandaj, sipas Haradinajt, nuk do të ketë ndonjë propozim për ndarje. Kryeministri ka theksuar se ShBA-ja nuk është tërhequr asnjëherë me rolin e saj në proceset në Kosovë



Amerikës", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se Amerika nuk është tërhequr asnjëherë me rolin e vet në ecuritë në Kosovë.

Ai ka theksuar se Kosova nuk e ka përjashtuar asnjëherë Amerikën dhe as që do të mund të bëjë ndonjë gjë të tillë. "Amerika nuk është tërhequr asnjëherë. Janë do prononcime këtu për qëllime ditore se, si Samiti i Berlinit apo Samiti i Parisit është përjashtim i Amerikës. Amerika nuk është dikush që përjashtohet prej proceseve, pra nuk mund ta përjashtojë askush Amerikën në proceset në Kosovë e në Ballkan. Edhe Amerika e vlerëson vetë se kur është momenti i duhur të ndërhyjë dhe të marrë përgjegjësi", ka theksuar kryeministri Haradinaj. Ai ka folur për pjesëmarrjen e ambasadores së Kosovës në ShBA, Vlora Çitaku, në iftarin e shtruar nga presidenti amerikan Donald Trump, duke thënë se bëhet fjalë për raporte të popujve dhe jo të individëve. Në këtë kontekst, kryeministri ka

deklaruar se marrëdhëniet e Amerikës me Kosovën nuk varen nga individët sepse ata vijnë dhe shkojnë, por varen nga të dy vendet. "Marrëdhëniet ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk varen prej individëve, por prej dy vendeve. Ka pasur ambasadorë para Vlorës e do të ketë edhe pas saj. Janë marrëdhënie mes vendeve. Temat e interesit kombëtar, shumica e ambasadorëve s'i kanë paraqitur si kryeministri. Ka pasur ndarje të brendshme për tema të rëndësishme. Besoj se e di secili që është mirë të konsultohemi për të shkuar me qëndrime të duhura", ka thënë Haradinaj. Kurse sa i përket rezolutës për gjenocidin serb në Kosovë, Haradinaj ka thënë se është koha që të qartësohet e kaluara. "Krimet po mohohen nga liderët serbë. Nuk po u pëlqen të pranojnë të vërtetën. Është koha të qartësohet e kaluara dhe viktimat t'i realizojnë të drejtat e tyre të mohuara deri tash", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

EPOKA ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 14 MAJ - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të martën se procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë tani është në duar të sigurta dhe se nuk flitet më për ndryshim të kufijve. Ai ka thënë se pas Samitit të Berlinit, dialogu është në duart e Gjermanisë dhe Francës. "Tani procesi i dialogut Kosovë - Serbi është në duar të sigurta, i është hequr nga duart Federica Mogherinit. Nuk rrezikojmë ndonjë propozim për ndarje. Tani

ka një stabilitet dhe kjo është kryesorja. Janë detyruar nivelet më të larta të BE-së ta heqin dialogun nga Mogherini që shkonte nga ndarja dhe tani vendimmarrja u kthye në Prishtinë. Pra, ne do t'i marrim vendimet", ka deklaruar kryeministri Haradinaj pas mbledhjes së qeverisë në një konferencë me gazetarë.

Sipas kryeministrit Haradinaj, fjalia e përfaqësueses së lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ditë më parë në Tiranë, se në momentin që hiqet taksat do të thërrasë menjëherë vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi, mund të përkthehet në ndarjen e menjëherëshme të Kosovës. "Mogherini ka thënë në Tiranë hiqeni taksën se jua ndaj Kosovën menjëherë. Ai ra ashtu? Si ta hiqni taksën unë e thërras takimin. A përkthehet kështu? Veç hiqeni taksën se menjëherë jua ndaj Kosovën. Shyqyr Zotit kemi qëlluar në vend dhe i kemi lexuar projektet me kohë. Nuk hiqet taksat. Mogherini e ka kryer mandatin e vet. E falënderoj Bashkimin Evropian që ka hequr agjendën e Mogherinit. Na ka bërë nder të madh. Rusia është tërhequr prej Ballkanit për kohë të gjatë. Ne nuk e parashohim në asnjë agjendë tonën Rusinë. Nuk i takojmë botës së Rusisë, por të

jehershme të Kosovës. "Mogherini ka thënë në Tiranë hiqeni taksën se jua ndaj Kosovën menjëherë. Ai ra ashtu? Si ta hiqni taksën unë e thërras takimin. A përkthehet kështu? Veç hiqeni taksën se menjëherë jua ndaj Kosovën. Shyqyr Zotit kemi qëlluar në vend dhe i kemi lexuar projektet me kohë. Nuk hiqet taksat. Mogherini e ka kryer mandatin e vet. E falënderoj Bashkimin Evropian që ka hequr agjendën e Mogherinit. Na ka bërë nder të madh. Rusia është tërhequr prej Ballkanit për kohë të gjatë. Ne nuk e parashohim në asnjë agjendë tonën Rusinë. Nuk i takojmë botës së Rusisë, por të

Raportet me ShBA-në janë shumë të rëndësishme për Kosovën

PRISHTINË, 14 MAJ (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të martën ka prit delegacionin amerikan të Lutjeve të Mëngjesit, të kryesuar nga kongresisti Randy Hutgren. Presidenti Thaçi e ka falënderuar delegacionin amerikan për përkrahjen e vazhdueshme për Kosovën. "Për ne janë shumë të rëndësishme raportet speciale me ShBA-në. Jam i lumtur që jam presidenti i shtetit më proamerikan në botë", u shpreh presidenti Thaçi. Në emër të delegacionit amerikan të Lutjeve të Mëngjesit, kongresisti

Randy Hutgren u shpreh i kënaqur me vizitën dhe takimet e mira që kanë pasur në Kosovë. Presidenti Thaçi në fund e ka falënderuar delegacionin amerikan, i cili shoqërohej edhe nga deputetë të ndryshëm të Kuvendit të Kosovës, që i kanë bërë bashkë përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve etnike, fetare dhe politike në Kosovë. "Bashkë me juve janë edhe përfaqësues të komuniteteve etnike, fetare dhe politike. Kjo është fytyra e vërtetë e Kosovës!", u shpreh presidenti Thaçi. Edhe kryetari i Kuvendit të

Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur në takim delegacionin amerikan të Lutjeve të Mëngjesit. Kryeparlamentari Veseli ka thënë se Kosova vazhdon të mbetet promovuese e paqes, respektit dhe fqinjësisë së mirë, gjithashtu edhe kultivuese e barazisë dhe mirëkuptimit midis komuniteteve etnike dhe konfesioneve të ndryshme. Veseli ka falënderuar Kongresin dhe shtetin amerikan për mbështetjen e pazezërve për Kosovën në të gjitha etapat, ndërsa ka konfirmuar edhe një herë miqësinë e pathyeshme midis Kosovës dhe ShBA-së.



Në takim ishin të pranishëm edhe deputetë të tjerë të Kuvendit, të angazhuar në aktivitetet e Lutjeve të Mëngjesit. Gjatë vizitës në Kosovë

kongresisti Randy Hutgren është takuar edhe me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe liderë të partive politike.

EPOKA ERE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Mbahet akademi përkujtimore për masakrat në Qyshk, Pavlan, Zahaq dhe Llabjan, të kryera nga forcat serbe 20 vjet më parë

Krerët e shtetit: Kryerësit e masakrave në Kosovë do të dënohen

"Shteti i Kosovës dhe kryetari i Kuvendit, të gjithë pa dallim, do ta nxjerrim rezolutën që dënon krimet e serbëve në Kosovë. Kjo rezolutë do të përcillet drejt implementimit të plotë, që ata që vranë mbi 13 mijë njerëz, të dënohen", ka thënë presidenti Hashim Thaçi në akademinë përkujtimore me rastin e 20-vjetorit të masakrës në fshatrat Qyshk, Pavlan, Zahaq dhe Llabjan të Pejës



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PEJË, 14 MAJ - Presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli dhe kryeministri Ramush Haradinaj kanë marrë pjesë të martën në akademinë përkujtimore për masakrat në Qyshk, Pavlan, Zahaq dhe Llabjan, të kryera nga forcat serbe 20 vjet më parë.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se mosdënimi i atyre që kryen masakra në Kosovë është diskriminim dhe fyerje e dinjitetit të viktimave të luftës. "Kosova ka pasur udhëtimin e vet të suksesit, lirisë dhe pavarësisë, por edhe sot, kur pritret që në javët e ardhshme ta shënojmë 20-vjetorin e fitores, mbetet brengë e madhe për të gjithë ne si institucione të Kosovës dhe si shoqëri, mbi të gjitha në ndërgjegjen e bashkësisë ndërkombëtare, që edhe sot e kësaj dite, pas 20 vjetëve, me mbi 400 masakra të kryera

askush nga serbët nuk është dënuar dhe kjo është padrejtësi, diskriminim dhe fyerje e dinjitetit të viktimave", ka thënë Thaçi në akademinë përkujtimore kushtuar masakrave në fshatrat Qyshk, Pavlan, Zahaq dhe Llabjan të Pejës.

Thaçi në këtë akademi ka përmendur rezolutën e propozuar nga kryeparlamentari Kadri Veseli për krimet e serbëve në Kosovë. "Shteti i Kosovës dhe kryetari i Kuvendit, të gjithë pa dallim, do ta nxjerrim rezolutën që dënon krimet e serbëve në Kosovë. Kjo rezolutë do të përcillet drejt implementimit të plotë, që ata që vranë mbi 13 mijë njerëz, të dënohen", është shprehur Thaçi.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se heshtjes ndërkombëtare dhe mohimit serb duhet t'i përgjigjemi si shtet, duke marrë të gjitha masat për dokumentimin e gjenocidit serb në Kosovë dhe duke krijuar kështu bazën fak-

tike për t'ia hapur rrugës Gjykatës Ndërkombëtare për Krimet e Serbisë në Kosovë.

Veseli ka deklaruar se të gjithë këta njerëz të pafajshëm janë vranë me urdhër politik nga shteti serb dhe janë ekzekutuar nga organet shtetërore të Serbisë në Kosovë, ushtria dhe policia. "Këto 13 500 viktima kërkojnë drejtësi. Këtë po e kërkojmë sot. Kosova ka të drejtë të kërkojë drejtësi për njerëzit e saj. Dhe drejtësia duhet të vijë në vend. Kriminelët të cilët i kanë kryer këto krime, duhet ta marrin

dënimin e merituar", ka theksuar Veseli. Ai ka thënë se shteti serb, edhe dy dekada pas luftës, nuk po pushon së provokuari dhe cenuari shtetin tonë. Sipas Veselit, ky duhet të jetë mesazh edhe për bashkësinë ndërkombëtare, e cila vetëm dy dekada më herët, pikërisht për të larguar një rrezik të tillë gjenocidi, kishte intervenuar ushtarakisht.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar në këtë akademi se më nuk do të lejojnë të mohohen krimet e serbëve të kryera në Kosovë. "Do ta mbrojmë me

ligj sakrificën, dhimbjen, të drejtën e viktimave. Nuk do ta lejojmë mohimin e krimeve. U kemi dhënë shans të gjitha drejtësive deri më tani që ta bëjnë këtë gjë, si UNMIK-ut ashtu edhe EULEX-it", ka thënë Haradinaj.

Para të pranishmëve në këtë akademi ka folur edhe kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, akademik Nexhat Daci. Me një kumtesë rreth masakrës u paraqit Ali Gashi, ndërsa në emër të familjeve të të rënëve të pranishmit i përshëndeti Naser Rama.

Komandant Bardhi me guxim dhe vendosmëri iu përgjigj kohës dhe atdheut

KAÇANIK, 14 MAJ (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe kryeparlamentari Kadri Veseli kanë marrë pjesë të martën në akademinë përkujtimore në 20-vjetorin e rënies së komandantit të Brigadës 162 "Agim Bajrami", Qamil Ilazit - komandant "Bardhi", si dhe bashkëluftëtarëve të tij Selim Shehu, Rizvan dhe Xhezair Bela, Sakip Mulaku, Ejup Dushkaja, Burhan Zeneli dhe Hesat Axhamisi.

Presidenti Thaçi ka thënë se nuk ka mbetur asnjë muaj nga koha kur Kosova do ta shënojë 20-vjetorin e çlirimit dhe ëndrra shekullore e shumë gjeneratave për liri dhe pavarësi nuk do të bëhej realitet pa mundin, përkushtimin, sakrificën dhe gjakun e dëshmorëve si dhe pa përkrahjen gjithëpopullore. "Këtë realitet që e jetojmë nuk do ta kishim pa rënien heroike të Qamil Ilazit dhe të

bashkëluftëtarëve të tij, pa rënien e dy mijë dëshmorëve dhe mijëra martirëve në vitet 1998-1999. Ndihej shumë krenar që Kaçaniku ka qenë një nga trevat që mbështeti fuqishëm Ushtrinë Çlirimtare. Çdo shtëpi e Kaçanikut me rrethinë ishte bazë e UÇK-së", u shpreh presidenti Thaçi.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se gjykata ndërkombëtare për krimet e shtetit serb në Kosovë është e domosdoshme, është e mundur, është e pashmangshme dhe do të ndodhë. Duke folur në akademinë përkujtimore kushtuar 20-vjetorit të rënies heroike të Qamil Ilazit - komandant "Bardhit" në Kaçanik, kryeparlamentari Veseli ka thënë se populli i Kosovës ka bërë luftë të drejtë dhe çlirimtare ndaj okupatorit serb, i cili vrau e masakroi mijëra qytetarë të



Kosovës. Veseli ka thënë se janë disa personalitete të cilat në jetën dhe

veprimtarinë e tyre pasqyrojnë gjithë fatin historik të kombit të tyre.

Një personalitet i tillë, tha Veseli, ishte Qamil Ilazi, komandant "Bardhi". "Qamil Ilazi, me guxim dhe vendosmëri, iu përgjigj kohës dhe atdheut, si njeri i lapsit dhe i pushkës. Në historinë e popullit tonë lapsi dhe pushka gjithmonë kanë shkuar bashkë. Qamil Ilazi me veprimtarinë dhe luftën e tij është shëmbëlltë e kësaj vlere të popullit tonë. Është shëmbëlltë e luftës sonë të drejtë, luftës së pastër, luftës sonë për liri e dinjitet kombëtar. Kjo luftë dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke i sjellë lirinë një populli të robëruar me shekuj, i ka bërë një shërbim të madh njerëzimit: e ka bërë më të drejtën botën", ka thënë Veseli, duke shtuar se të gjithë ata që kishim nderin të jenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, qëndrojnë krenarë dhe ballëhapur para çdo kujt.

Flet për "Epokën e re", Adrijana Hoxhiq

Zgjedhjet në veri do

Ministrja e Administrimit e Pushtetit Lokal, Adrijana Hoxhiq, beson se zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale në katër komunat veriore do të shkojnë mirë dhe pa ndonjë problem në terren. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se pret që procesi zgjedhor të jetë korrekt dhe demokratik. Hoxhiqi i ka ftuar të gjithë qytetarët e këtyre komunave veriore që të dalin në zgjedhjet e 19 majit dhe të votojnë sipas vullnetit të tyre. Sipas saj, institucionet kompetente i kanë marrë veprimet edhe në planin e sigurisë

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 MAJ - Ministrja e Administrimit të Pushtetit Lokal, Adrijana Hoxhiq, ka shprehur bindjen se zgjedhjet e jashtëzakonshme lokale për kryetar të Komunës së Leposaviqit, të Zubin Potokut, të Zveçanit dhe të Mitrovicës së Veriut do të shkojnë mirë. Ajo ka deklaruar se të gjitha institucionet kompetente i kanë marrë të gjitha veprimet që të ketë një ecuri zgjedhore korrekte dhe demokratike.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxhiqi i ka ftuar qytetarët e këtyre komunave që të marrin pjesë në këto zgjedhje dhe të votojnë sipas vullnetit të tyre. "Unë luftoj për demokraci të lartë dhe për cilësi në demokraci. Jam shumë e bindur se në terren nuk do ta kemi ndonjë problem. U bëj thirrje të gjithë qytetarëve që të votojnë sipas mendimit dhe vullnetit të tyre", ka thënë Hoxhiq.

Ajo ka treguar se institucionet i kanë marrë masat e duhura edhe në aspektin e sigurisë. "Jam e bindur se aktorët dhe institucionet kompetente do ta bëjnë punën e tyre që ta kemi nivelin e sigurisë në mënyrën e duhur", është shprehur ajo.

Hoxhiq ka shprehur optimizëm se kryetarët e rinj të këtyre komunave nuk do të japin dorëheqje pas zgjedhjeve. "Nuk dua ta mendoj këtë skenar. Shpresoj që kryetarët që do të zgjedhën në këto zgjedhje nuk do të japin dorëheqje. Por, nëse vijnë deri në atë gjendje, Ministria e Pushtetit Lokal nuk është institucioni që merret me këtë çështje. Është presidenti i Kosovës i cili i shpallë zgjedhjet dhe më pas janë institucionet e tjera që i organizojnë ato", ka thënë ajo.

Në këtë intervistë Hoxhiq ka folur edhe për punën si ministre e Administrimit të Pushtetit

Lokal. Ajo ka treguar se deri më tani nuk ka pasur kurrfarë presioni nga askush. "Vërtet gjatë kësaj kohe nuk kam pasur kurrfarë presioni për marrjen e këtij posti. Mendoj se të gjithë e kanë kuptuar se angazhimi im ndërlidhet ekskluzivisht me përvojën e punës që unë kam në vetëqeverisjen lokale. Në anën tjetër, unë me punën e deritanishme kam treguar interesim që t'u ndihmoj të gjithë qytetarëve të Kosovës", ka thënë Hoxhiq.

"Epoka e re": Znj. Hoxhiq, i keni bërë më shumë se një muaj që kur keni marrë postin e ministres së Administrimit të Pushtetit Lokal. Gjatë kësaj kohe, a keni pasur ndonjë presion nga jashtë për marrjen e këtij posti?

Hoxhiq: Vërtet gjatë kësaj kohe nuk ka pasur kurrfarë presioni për marrjen e këtij posti. Mendoj se të gjithë e kanë kuptuar se angazhimi im ndërlidhet ekskluzivisht me përvojën e punës që unë kam në vetëqeverisjen lokale. Në anën tjetër, me punën e deritanishme kam treguar interesim që t'u ndihmoj të gjithë qytetarëve të Kosovës. Kështu që, ky përkushtim imi do të mbetet i njëjtë. Përveç Komunës së Mitrovicës Veriore, duhet ta mbikëqyrim punën edhe në 37 komunat e tjera që ekzistojnë në Kosovë.

"Epoka e re": Kemi pasur raste që individët që kanë marrë postet e ministrave nga radhët e Listës Serbe u është bërë presion nga ky subjekt politik.

Hoxhiq: Nuk ka ndodhur kjo sepse unë me angazhimin tim në Komunën e Mitrovicës Veriore kam pasur bashkëpunim me këtë listë dhe me punën që unë e kam bërë është krijuar ajo ura e besimit. Shpresoj se jo vetëm qytetarët serbë të Kosovës, por edhe qytetarët e tjerë kanë krijuar një besim. Unë do të punoj me përkushtim dhe interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës.



të shkojnë mirë

"Epoka e re": Domethënë, raportet e juaja me Listën Serbe nuk kanë ndryshuar prej marrjes së këtij posti?

Hoxhiq: Nuk kanë ndryshuar jo vetëm me Listën Serbe, por me asnjë parti tjetër politike. Raportet e mia janë të njëjta me të gjithë. Në fillim të marrjes së mandatit unë kam treguar se emërimi im në këtë post nuk ka të bëjë fare me politika të larta. Besoj se ky mesazh ka dhënë rezultat, sepse ata që me njohin e dinë se jam e sinqertë dhe kjo ka luajtur rol në këtë drejtim.

"Epoka e re": Këtë të diel do të mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme në katër komunat në veri të Kosovës, atje ku ju më herët keni shërbyer. Çka pritni nga këto zgjedhje?

Hoxhiq: Shpresoj se do ta kemi

një proces demokratik zgjedhor në këto komuna. Ju e dini se nuk ka edhe shumë kandidatë që do të garojnë për kryetar të këtyre komunave. Dhe tani po e shfrytëzoj këtë rast që përmes gazetës suaj t'u uroj të gjithë kandidatëve suksese në këtë proces zgjedhor.

"Epoka e re": Në aspektin e sigurisë, çka kanë bërë institucionet qendrore që të dielën ta kemi një proces të qetë dhe demokratik?

Hoxhiq: Jam e bindur që aktorët dhe institucionet kompetente do ta bëjnë punën e tyre që ta kemi nivelin e sigurisë në mënyrën e duhur.

"Epoka e re": A ekzistojnë kushtet e duhura demokratike

për zhvillimin e këtij procesi zgjedhor, sepse disa subjekte politike serbe nuk do të marrin pjesë në këtë proces, me arsyetimin se kandidatët e tyre mund të rrezikohen?

Hoxhiq: Nuk mund të flas në emër të askujt por gjërat e tilla patjetër duhet të raportohen tek institucionet relevante, të cilat duhet të merren me këtë çështje. Unë luftoj për demokraci të lartë dhe për cilësi në demokraci. Jam shumë e bindur se në terren nuk do ta kemi ndonjë problem. U bëj thirrje të gjithë qytetarëve që të votojnë sipas mendimit dhe vullnetit të tyre.

"Epoka e re": Pra, besoni se do të shkojë gjithçka në rregull?

Hoxhiq: Ne do të kemi zgjedhje demokratike dhe të rregullta,

duke e respektuar ligjin për këto zgjedhje. Asgjë më shumë nuk mund të them, vetëm shpresoj dhe mendoj se nuk do të kemi probleme në terren.

"Epoka e re": Është përmendur mundësia që pasi të zgjedhen kryetarët e rinj, sërish ata do të japin dorëheqje. A janë institucionet e përgatitura për këtë skenar?

Hoxhiq: Nuk dua ta mendoj këtë skenar. Shpresoj që kryetarët që do të zgjedhen në këto zgjedhje nuk do të japin dorëheqje. Por, nëse vijnë deri në atë gjendje, Ministria e Pushtetit Lokal nuk është institucioni që merret me këtë çështje. Është presidenti i Kosovës i cili i shpallë zgjedhjet dhe më pas janë institucionet e tjera që i organizojnë ato.

Veseli: Muze për gjenocidin, që krimet e tilla të mos përsëriten

PRISHTINË, 14 MAJ (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka përsëritur edhe një herë qëndrimin e tij se Serbia dhe kriminelët që fshihen në këtë shtet dhe gjetiu do të përgjigjen për gjenocidin e kryer në Kosovë.

Gjatë një vizite në lokacionin ku do të ndërtohet Muzeu i Gjenocidit, përkatësisht hapësirat e ish-Tjegullores në Prishtinë, kryeparlamentari Veseli ka thënë se ky muze do të ketë rol edukativ për brezat e ardhshëm, ndërsa ka paralajmëruar se gurthemeli i tij pritet të vendoset në vitin 2020. Duke radhitur arsyet e tjera për ngritjen e këtij muzeu, Veseli ka thënë se ai do të shërbejë si qendër dokumentimi dhe hulumtimi për krimet e kryera, si dhe qendër përkujtimi për viktimat e këtyre krimeve, në mënyrë që krime të tilla mos të përsëriten kurrë më.

Kreu i Kuvendit falënderoi organizatat dhe mekanizmat e tjerë vendorë e ndërkombëtarë të cilat merren me ndriçimin e të vërtetës dhe kanë shprehur interesin për iniciativën. Veseli ka falënderuar edhe Kongresin Amerikan për mundësinë që dha që këto krime të rrëfehen.

"Kjo është një iniciativë që populli i Kosovës e merr për hir të së drejtës dhe të vërtetës. Nuk ka pajtim pa pasur dënim të gjenocidit. Ditën e enjte do të kemi seancë, kur edhe do të themelohet komisioni shtetëror që fillon punën e dokumentimit të së vërtetës dhe më pas iniciimin e tri-

bunalit", ka theksuar kryeparlamentari Veseli. Gjithashtu, Veseli ka bërë me dije se të enjten do të fillohet edhe me Muzeun e Gjenocidit dhe do të propozohet pikërisht ky vend për ndërtimin e tij. Ai ka thënë se ka aq shumë fakte për krime sa nuk ka mbulesë dhe forcë që mund ta ndalojë

këtë tribunal. "Serbia duhet të paguajë dhe kriminelët duhet të paguajnë për gjenocidin", është shprehur Veseli. Kreu i Kuvendit ka falënderuar Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ministrinë e Kulturës, të cilat, sipas tij, po bëjnë një punë të shkëlqyeshme.



Ismet Temaj zgjedhet rektor i Universitetit "Ukshin Hoti"

PRIZREN, 14 MAJ (ER) - Në mbledhjen e mbajtur të martën me votim unanim të anëtarëve të pranishëm (gjashtë vota) të Këshillit Drejtues është zgjedhur rektor në Universitetin "Ukshin Hoti" në

Prizren prof. asoc. dr. Ismet Temaj, i cili nga viti 2001 ka punuar profesor në ShLP "Xhevdet Doda", ndërsa nga viti 2004 profesor në Fakultetin e Edukimit në Universitetin e Prishtinës, ku ishte

edhe shef i programit. Që nga themelimi ka punuar profesor në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, ndërkaq prej vitit 2012 deri 2018 ka ushtruar edhe funksionin e dekanit në Fakultetin e Edukimit

në këtë universitet. Nga fundi i vitit të kaluar është zgjedhur në pozitën e u. d. rektorit në UPZ. Në bazë të statutit mandati i rektorit është katër vjet, me mundësi rizgjedhje edhe për mandat.



Kryeministri i premtion rektorit të UP-së se do ta përkrahë arsimin e lartë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim një delegacion të profesorëve dhe dekanëve nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", i kryesuar nga rektori Marjan Dema, me të cilët ka biseduar rreth gjendjes në Universitetin e Prishtinës dhe arsimin të lartë në përgjithësi. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka shprehur përkrahimin e Qeverisë së Kosovës për mbështetjen e Universitetit të Prishtinës dhe arsimin të lartë në përgjithësi, duke

vlerësuar se ngritja e cilësisë në arsim është e një rëndësisë të veçantë për vendin, marrë parasysh trendet dhe zhvillimet e hovshme globale. "Universiteti i Prishtinës është aset kombëtar dhe pikë orientuese e zhvillimit të shoqërisë tonë, të cilin qeveria e vendit do ta mbështesë në vazhdimësi, me qëllim të avancimit profesional, konform trendeve globale", ka thënë Haradinaj. Në këtë takim kryeministri Haradinaj u informua për sfidat e Universitetit të Prishtinës, me theks të veçantë për mungesën e laboratorëve dhe për mënyrën e rifunksionalizimit efektiv të insti-

tuteve në fakultetet përkatëse si dhe për mbrojtjen e profesioneve të veçanta dhe rigjenerimin e kapaciteteve kadrovike, sidomos në inxhinierinë elektrike dhe në fushën e matematikës. "Arsimi si një nga prioritetet kryesore të qeverisë do ta ketë mbështetjen e vazhdueshme edhe në të ardhmen. U gëzohemi arritjeve dhe sukseseve të studentëve tanë të cilët duhet të jenë konkurrentë për tregun global", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke vlerësuar se është e rëndësishme të investimi në infrastrukturën e domosdoshme për zhvillim normal të punës në



arsimin e lartë. Në këtë takim palët u morën vesh që të bëhet një plan për rishqyr-

timin e normativave ligjore të arsimin të lartë si dhe shpenzimet e nevojshme.

Klinika e Syve i shpëton shikimin një foshnje

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 MAJ - Një ekip i mjekëve specialistë në Klinikën e Syve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) ka kryer me sukses një ndërhyrje në sy të një fëmijë njëmuajsh, duke ia shpëtuar të pamurit, pasi ishte diagnostikuar me retinopati premature, që çon në verbërim të përhershëm. Kjo sëmundje shfaqet të fëmijët e lindur para kohe dhe zakonisht shkaktohet nga rritja e çrregullt e enëve të gjakut të cilat dëmtojnë retinën e syrit.



Fëmija ka qëndruar për katër javë në Klinikën e Neonatologjisë. Nga ekzaminimet e bëra, mjekët kanë konstatuar se ndërhyrja e menjëhershme është e domosdoshme për t'ia shpëtuar foshnjës sytë. Dr. Ardian Sermaxhaj ka pohuar se pacienti tash është mirë, nën përcjellje të mjekëve, gjersa flet për pasojat nëse rasti nuk do të trajtohej me kohë. "Foshnja tash është mirë dhe nuk ka kurrfarë problemi. Është në javën e 36. Jemi duke e përc-

jellë. Po të mos identifikohet problemi me kohë, pas dy javësh do të mund të ndodhte shkalla e tretë apo e katërt e retinopatisë premature, që do të çonte në verbërim të përjetshëm", ka thënë Sermaxhaj. Klinika e Syve ka formuar një ekip prej pesë mjekësh për trajtimin e sëmundjes së

retinopatisë premature. Përveç dr. Ardian Sermaxhaj, aty bën pjesë edhe dr. Anita Sylaj, dr. Festim Bllata, dr. Visar Huruglica dhe dr. Belinda Pustina.

Drejtori i Klinikës së Syve, dr. Adem Miftari, ka theksuar se QKUK-ja ka kapacitet të trajtojë të shumicën e rasteve të kësaj natyre pa pasur nevojë për referim jashtë vendit. "Menaxhmenti i klinikës, bashkë me mjekët, punojnë në ekipin që diagnostikon dhe trajton retinopatinë premature. Jemi duke punuar edhe në hartimin e protokollit për diagnostikimin dhe trajtimin e kësaj sëmundjeje, duke u bazuar në përvojat e mjekësisë kulminante. Ne kemi kapacitet ta trajtojmë shumicën e rasteve me probleme të retinopatisë premature. Sa i përket trajtimit të këtyre sëmundjeve, jemi në një nivel me vendet e përparura të botës. Presim që të furnizohemi me pajisje shtesë, në mënyrë që t'i trajtojmë të gjitha rastet", ka thënë Miftari. Në Klinikën e Syve për dy vjet janë trajtuar 27 raste suksesshëm me retinopati premature.

Ministri Bytyqi kërkon të unifikohet sistemi arsimor në mes të Kosovës dhe Shqipërisë

PRISHTINË, 14 MAJ (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të martën në takim një delegacion të përbërë nga anëtarë të Komisionit Parlamentar për Edukim dhe Mjete të Informimit të Shqipërisë, të shoqëruar nga ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi.

Këtë takim, në të cilin u diskutua nevoja për shtimin e bashkëpunimit në fushën e arsimit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, ministri Bytyqi e vlerësoi të një rëndësie të veçantë. Duke folur për marrëveshjet e deritanishme në mes të dy vendeve, ministri Bytyqi ka thënë se është interes i përbashkët të

shkojmë drejt unifikimit të sistemit arsimor. "Prej kohës sa jam në krye të Ministrisë së Arsimit ekziston një bashkëpunim i ngushtë dhe shpesh kemi dalë përtej marrëveshjeve formale. Në kuadër të kësaj kemi filluar zbatimin e marrëveshjes për shkëmbim të nxënësve të nivelit të arsimit të mesëm, e cila është pilotuar me sukses", ka thënë ministri Bytyqi.

Në anën tjetër, kryetarja e Komisionit për Edukim dhe Mjete të Informimit, Fatjona Dhimitri, ka falënderuar ministrin Bytyqi për pritjen, duke u shprehur e gatshme për bashkëpunim të dyanshëm në të mirë të ngritjes së cilësisë në arsimin e të dy vendeve.



Instituti Arkeologjik kërkon që të ruhet zona arkeologjike në fshatin Dresnik

KLINË, 14 MAJ (ER) - Komunën e Klinës e kanë vizituar përfaqësues të Institutit Arkeologjik të Kosovës të cilët janë pritur në takim nga drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Skender Merturi,

dhe bashkëpunëtorë të tjerë. Qëllimi i kësaj vizite ishte të diskutohet mbi mbrojtjen dhe ruajtjen e zonës arkeologjike në fshatin Dresnik prej 64 hektarësh dhe perimetri i asetit prej

16.7 hektarësh. Me këtë rast, drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Skender Merturi, i ka falënderuar përfaqësuesit e Institutit Arkeologjik të Kosovës për bashkëpunimin e deri-

tashëm dhe ka konfirmuar se Komuna e Klinës do ta vazhdojë zbatimin e ligjeve të Republikës së Kosovës për ruajtjen e këtij aseti unik dhe të rëndësishëm që ka Klina.



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Qeveria kërkon zbatim më të shpejtë të reformave për MSA-në

Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë me dije se shkalla e përgjithshme e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) gjatë tremujorit të parë të këtij viti është 5.99 për qind. Në mbledhjen e kabinetit qeveritar ajo ka treguar se nga 401 masa të planifikuara, vetëm 24 prej tyre janë zbatuar plotësisht. Ministria Hoxha ka kërkuar zbatimin më të shpejtë të reformave për MSA-në

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 14 MAJ - Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, është shprehur e pakënaqur me nivelin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit gjatë periudhës janar - mars të këtij viti. Në mbledhjen e së martës të kabinetit qeveritar ajo ka thënë se shkalla e përgjithshme e zbatimit të MSA-së gjatë periudhës raportuese është 5.99 për qind, pasi që 24 nga 401 masa të planifikuara janë zbatuar plotësisht, ndërsa nga këto 24 masa të zbatuara 12 prej tyre janë zbatuar para afatit të planifikuar. "Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) për vitin 2019 ka paraparë 401 masa afatshkurtra, prej të cilave 160 ose 39.9 për qind e tyre janë masa legjislative, ndërsa 241 masa ose 60.10 për qind e tyre janë masa zbatuese. Shkalla e përgjithshme e zbatimit të Programit gjatë periudhës raportuese janar-mars 2019 është 5.99 për qind pasi që 24 nga 401 masa të planifikuara janë zbatuar plotësisht, ndërsa nga këto 24

masa të zbatuara, 12 janë zbatuar para afatit të planifikuar", është shprehur ministria Hoxha.

Kurse sa i përket shkallës së zbatimit të masave të planifikuara për t'u zbatuar brenda tremujorit të parë, ajo ka thënë se 30 për qind e masave janë zbatuar plotësisht, ndërkaq 70 për qind e masave nuk janë zbatuar plotësisht pasi përballen me vonesa serioze. "Shkalla e zbatimit të masave legjislative të planifikuara për t'u zbatuar brenda tremujorit të parë, të gjeturat tregojnë si në vijim: 25.81 për qind e masave janë zbatuar plotësisht, 74.19 për qind e masave akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze", ka deklaruar ajo.

Ministria Hoxha ka bërë me dije se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka zbatuar masat 100 për qind, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 80 për qind, Ministria e Punëve të Brendshme 50 për qind, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë 42.11 për qind, Ministria e Administratës Publike 25 për qind, ndërsa tetë ministri e kanë pasur nga një masë të cilën



nuk e kanë zbatuar.

Gjithashtu, sipas të gjeturave, ministria Hoxha ka theksuar edhe reformat kyçe të planifikuara që nuk kanë gjetur zbatim janë 17 akte nënligjore, dy projektligje, një strategji, një koncept dokument dhe projektligji doganor dhe i akcizave. "Masat zbatuese të planifikuara për t'u zbatuar brenda tremujorit të parë, të gjeturat tregojnë si në vijim: 44.44 për qind e masave janë zbatuar plotësisht, 55.56 për qind e masave akoma nuk janë zbatuar plotësisht, pra përballen me vonesa serioze", ka theksuar Hoxha. Po ashtu, mbështetjen e qeverisë e ka marrë nisma për lidhjen e marrëveshjes financiare trepalëshe në mes të Bashkimit Evropian, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2018 për Programin e Bashkëpunimit

ndërkufitar për IPA.

Me këtë rast, ministria Dhurata Hoxha ka thënë se kjo marrëveshje do të mundësojë rritje të përfitimit nga fondet e IPA-s për bashkëpunim ndërkufitar në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. "Marrëveshja mundëson zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar mes dy vendeve në kuadër të alokimit të fondit IPA për vitin 2018, në fusha si mbrojtja mjedisore, turizmi, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, tregtia dhe investime", është shprehur Hoxha.

Kabineti qeveritar në mbledhjen e së martës ka ndarë mjete financiare për implementimin e projektit Kompakt të Zyrës për Sfidat e Mijëvjeçarit në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Po ashtu, janë ndarë mjete financiare për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së

Republikës së Kosovës në Qendrën Rajonale të Nismës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI) me seli në Shkup për vitin 2019.

Ndërsa zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka njoftuar kabinetin qeveritar rreth përgatitjeve që janë duke u bërë për mbajtjen e mbledhjes së përbashkët ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Maqedonisë së Veriut.

Edhe ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, e ka informuar kabinetin qeveritar se më 29 maj do të bëhet përfundimi i autostradës "Arbën Xhaferi" Prishtinë - Hani i Elezit. Kurse ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhilar, e ka informuar kabinetin qeveritar për procesin e reformës në administratën publike dhe për rishikimin e agjencive të pavarura.

Delegacioni i bizneseve amerikane njoftohet me mundësitë për investime në Kosovë

PRISHTINË, 14 MAJ (ER) - Një delegacion i bizneseve amerikane ka qëndruar të martën në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë, ku është takuar me disa përfaqësues të bizneseve që operojnë në Kosovë. Qëllimi i takimit të tyre ishte informimi lidhur me mundësitë që ofron Kosova për investitorët amerikanë.

Kryetari i Bordit të Odës Amerikane, Ilir Ibrahim, ka njoftuar të pranishmit me mundësitë e shumta për investime të cilat ofron Kosova në sektorë të ndryshëm. Ai ka thënë se numri i madh i bizneseve të suksesshme është dëshmi e vullnetit dhe punës së madhe të bizneseve vendore për t'u rritur më tutje.

Ibrahim ka thënë se rrjetëzimi mes bizneseve vendore dhe atyre amerikane është ndër mënyrat më të mira për t'i forcuar marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës dhe për të siguruar numër më të lartë të investimeve



amerikane në vend.

Një nga biznesmenët amerikanë, pjesë e delegacionit, Michael Stoltzfus, u interesua lidhur me kualitetin e arsimit në vend si dhe me zhvillimin e ndërmarrjes së

disa nga shtyllat kyçe për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Stoltzfus ka përmendur rininë e Kosovës si një aset mjaft të vlefshëm i cili mund të rezultojë në

rritje më të qëndrueshme të vendit duke reflektuar në themelimin e një numri më të madh të ndërmarrjeve të reja që pastaj përkthehet në vende të reja pune. Më tutje, përfaqësuesit e bizne-

seve diskutuan rreth mundësive të bashkëpunimit me bizneset amerikane në projekte konkrete në fusha të ndryshme duke u pajtuar për vazhdim të komunikimit mes tyre.



Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të martën seancë të jashtëzakonshme për gjendjen në Telekomin e Kosovës

Debat koti për Telekomin

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës, e thirrur nga partitë opozitare, Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës për gjendjen në Telekomin e Kosovës, ka përfunduar të martën pa ndonjë rezultat, pasi nuk ka arritur të dalë në votim rezoluta për Telekomin për shkak të mungesës së kuorumit. Për gjendjen në Telekomin e Kosovës, kompani kjo e cila ndodhet në prag të falimentimit, ka pasur akuza reciproke ndërmjet deputetëve të partive në pushtet dhe atyre të opozitës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 MAJ - Ka përfunduar pa ndonjë rezultat të martën seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës në të cilën është diskutuar për gjendjen në Telekomin e Kosovës. Në këtë seancë, e cila ishte thirrur nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), nuk ka arritur të dalë në votim rezoluta për Telekomin për shkak të mungesës së kuorumit. Për disa orë në këtë seancë është diskutuar në lidhje me gjendjen e Telekomit dhe kontratën e kësaj ndërmarrje me "Z-Mobile". Gjatë kësaj seance ka pasur edhe akuza dhe kundërakuza në mes të deputetëve të pozitës dhe opoz-

itës në lidhje me gjendjen e Telekomit. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, njëherësh kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), ka thënë se të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me keqpërdorime, me mbipunësime apo tenderë, duhet të zbulohen, por jo në aspektin politik. "Kanë me dalë me emra dhe mbiemra, për arsye se janë njerëzit dhe faktet aty. Nuk ka nevojë për manipulime pasi ka shtet, ka ligj, ka prokurorë në këtë vend. Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me keqpërdorime, punësime dhe tender duhet të shkojnë deri në fund, por nuk do të ketë shkarkim nga foltorja e Kuvendit", ka thënë Veseli. Ndërkaq kryeministri Ramush

Haradinaj ka thënë se nëse përgjegjësit e Telekomit nënshkruajnë ose vazhdojnë kontratat të tilla me kompani private në dëm të Telekomit do të përballen me ligjin. Ai ka paralajmëruar se qeveria nuk do të ndajë mjete financiare për Telekomin. "Nuk mund t'i japim para të popullit një kompanie që në planin e biznesit nuk i ka sqaruar gjërat. Si mund t'i japim para të buxhetit një kompanie që është nën hetime. Duhet të kërkojmë llogaridhënie dhe mos të nënshkruajë askush, as vazhdim të kontratës që është në terma të biznesit e shpjeguar e cila e mbron interesin e kompanisë publike", ka thënë Haradinaj. Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës

(LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se kriza në Telekomin e Kosovës është thelluar nga punësimet pa kriterë. Hoti ka theksuar se PTK-ja është në falimentim për shkak të kontratave të dëmshme me kompani private. "Këto kontrata janë bërë për ta shkatërruar Telekomin dhe për të bërë përfitime të caktuara. Mbrojtja e Telekomit në arbitrazh është neglizhuar për shkak të borxhit që 'Z-Mobile' po e mban varur", ka deklaruar Hoti. Ai ka thënë se arsye tjetër e falimentimit të PTK-së është punësimi i militantëve në Telekom dhe për shkak të qindra lëndëve që i kanë në gjykata. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, gjatë seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit për çështjen e Telekomit të Kosovës ka thënë se kontrata e Telekomit me "Z-Mobile" është krim i organizuar. Kurti ka theksuar se kontrata me "Z-Mobile" është aktuale dhe se dëmet e kësaj kontrate joligjore vazhdojnë të thellohen çdo ditë. "Z-Mobile" dëshiron që ta marrë të tërë Telekomin. Prapa saj qëndron presidenti dhe ish-shefi i shefave", ka thënë Kurti. Më tutje, Kurti ka thënë se në vitin

2009 Telekom i Kosovës i ka dhënë buxhetit të shtetit 200 milionë euro, ndërsa sot po e kërcënon falimentimin. Ai ka thënë se privatizimi i Telekomit është problem i madh. "Privatizimi është problem shumë i madh. Është e vërtetë që një pjesë e aksioneve iu takon privatëve. Shteti i fuqishëm e ka luksin të japë privatizim, mirëpo një shtet për tokë si Kosova nuk e ka këtë luks", ka thënë Kurti. Deputeti i Partisë Socialdemokrate (PSD), Visar Ymeri, ka thënë se Telekom i Kosovës është në buzë të greminës. Ai ka thënë se duhet të angazhohen që ta ndalin privatizimin e Telekomit përmes shpronësimit. "Telekom i Kosovës ka ardhur buzë greminës nga kontratat për kryerje shërbimesh me palët e treta, shërbime këto që më së miri i kryen vetë ndërmarrja. Këto kontrata kanë rritur shpenzimet, ndërkohë që për punët e njëjta janë rritur punësimet brenda ndërmarrjes: klientelizëm partiak dhe privatizim përmes nënkontraktimit. Rruga që propozon qeveria është privatizim përmes shpronësimit."

Ndahen 780 koshere dhe pajisje për bletarë në vlerë rreth 20 mijë euro

Kamenicë, 14 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Naim Arifin, dhe në

bashkëpunim me RESI-n austriak dhe Shoqatën e Bletarëve "Luzma", kanë bërë shpërndarjen e 780 koshereve dhe pajisjeve të tjera për bletë, për 52 bletarë të kësaj komune.

Kryetari Kastrati ka thënë se Kamenica ka kushte mjedisore mjaft të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë dhe në këtë drejtim po përpiqen që ta përkrahin vazhdimisht edhe

sektorin e bletarisë. Ky projekt është bërë në bashkëpunim me RESI-n austriak, Shoqatën e Bletarëve "Luzma" dhe Komunën e Kamenicës për t'u dalë në ndihmë bletarëve.





Që të dyja duhet t'i ndalim", ka thënë Ymeri.

Shefi i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate, Bilall Shefiri, ka ofruar disa zgjidhje për gjendjen e Telekomit. "Nëse duhet ta mbajmë si kompani publike duhet ta nxjerrim nga kjo gjendje, të gjithë së bashku, menaxhmeti, bordi i Telekomit, qeveria dhe ministra duhet ta kenë një projekt se si duhet ta mbajmë një kompani publike pasi kemi nevojë për të. Por, nuk e di a jemi të gatshëm ta bëjmë këtë", ka thënë Sherifi. Ai ka thënë se nëse dëshirohet të shpëtohet Telekom, atëherë duhet t'i hiqen pengesat.

Deputeti i AAK-së, Shkumbin Demaliaj, ka bërë me dije se ka listën me emrat e 42 politikanëve të cilët kanë familjarë të tyre të punësuar në Telekomin e Kosovës. Sipas tij, Telekomin nuk bën të pri-

vatozohet pa u zbardhur e tërë çështja dhe të përfundojë hetimi. Borxhi prej rreth 26 milionë eurosh që Telekomin i Kosovës i ka kompanisë "Z-Mobile" ka të bëjë me mospërbushjen e kontratës nga ana e Telekomit për dhënie e 100 mijë numrave të telefonit dhe shërbimeve të internetit 3G dhe 4G. Borxhi ndaj kompanisë në fjalë është vendosur nga arbitrazhi ndërkombëtar dhe është konfirmuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe nga Gjykata e Apelit. Kompania "Z Mobile" fillimisht kishte kërkuar që Telekomin ta kthejë borxhin brenda dy javësh por, pas një marrëveshjeje të arritur nga Komiteti Ndërmarrësor i Ndërmarrjeve Publike, i udhëhequr nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Ljuka dhe përfaqësues të kompanisë "Z Mobile", afati i shlyerjes së borxhit është 15 qershori i këtij viti.

Si të shpëtohet PTK-ja?



Nga Jakup KRASNIQI

Një gjë duhet ta dimë që të gjithë: Post Telekomin e Kosovës nuk mund ta shpëtojë parti politike që vrapojnë për të rrëmbyer pushtet, por parti që luftojnë fort për ta funksionalizuar në çdo segment shtetin e së drejtës. Po a kemi parti të tilla që vërtet dëshirojnë ta bëjnë funksional shtetin e së drejtës?

Në këtë pyetje, duke e njohur realitetin e hidhur në Kosovë, nuk mund të jap përgjigje pozitive dhe për këtë me vjen shumë keq. Por, ajo që mund të them është se nuk është duke u parë vullnet se dikush do që ta zgjidhë këtë problem tepër të ndërlikuar dhe të ndërlikuar enkas nga vetë politika.

Në kohën e fundit është bërë shumë zhurmë për punësimin. Punësimi, edhe pse është problem në vete dhe jo vetëm në PTK, duhet të themi se edhe punësimi më i keq nuk mund ta sillte PTK-në në këtë gjendje alarmante.

Në këtë gjendje alarmuese, mbase edhe falimentuese këtë ndërmarrje publike, e ritheksoj nuk e ka sjellë punësimi i skajshëm joprofesional, edhe pse punësimi ka qenë dhe është krejt joprofesional dhe skajshmërisht i papërgjegjshëm. Në këtë gjendje PTK-në e kanë sjellë të gjitha kontratat pa përjashtim.

Në një situatë të tillë nuk ka si mos të bëhet një pyetje: Kush janë përgjegjësit e kësaj gjendjeje?

A janë ata drejtuesit e PTK-së apo kryeqeveritarët, sidomos ata të para e pas pavarësisë së Kosovës, natyrisht pa i amnistuar pararendësit e tyre (administrimi ndërkombëtar). Përgjegjësia është e të gjithë atyre që kanë urdhëruar e nënshkruar kontrata të dëmshme për këtë ndërmarrje publike shumë fitimprurëse.

Po të funksiononte shteti ashtu siç u tha nga dikush sot në Kuvend, shteti do të duhej ta shpallte gjendjen e jashtëzakonshme para se të ndodhte falimentimi dhe pastaj t'i merite masat konform gjendjes ekzistuese. Do ta kërkonte ndërprerjen e të gjitha kontratave, të gjitha llojeve të marketingut e të dhuratave të ndryshme dhënë njerëzve të lidhur ngushtë me politikën e lartë dhe kjo derisa të bihet një përfundim ligjor nga sistemi i drejtësisë. Por, krejt çështja është sa kemi drejtësi të pavarur në Kosovë? Ajo që dihet është se, përgjegjësia për gjendjen e tanishme bie mbi të gjitha qeveritë e pas pavarësisë, të gjitha menaxhmentet e deritashëm të PTK-së pa përjashtim kanë kontribuar për ta sjellë në këtë derexhe, këtë ndërmarrje publike shumë fitimprurëse.

Pa dyshim që zgjidhje ka, po zgjidhja nuk bëhet nga parti që këtë gjendje e kishin dhe e kanë qëllim kryesor për të fituar vota në zgjedhjet e ardhshme parlamentare! Duhet një trupë profesionale për të ofruar zgjidhje afatgjatë të kësaj krize të

stërzgatur. Por, pa vullnetin politik të kryeqeveritarëve të koalicionit/koalicioneve qeverisëse për të bërë një zgjidhje të drejtë kësaj pasurie publike, vështirë se do të ketë zgjidhje të dëshiruar për publikun.

Dikush po e sheh privatizimin e saj si zgjidhje. Mbase ata e dinë edhe kush duhet të jetë blerësi i saj! Ndoshta edhe privatizimi është zgjidhja më e mirë sesa kaosi dhe kriza e thellë që mund ta falimentojë edhe shtetin.

Ekziston bindja se kriza në PTK mund të zgjidhet nëse kryeministri/koalicioni i Kosovës e krijon një Taks Forcë me njerëz që dinë e duan t'i ndihmojnë vendit, po ama këta njerëz nuk gjenden në kabinetin kinez të qeverisë! Njerëz të tillë në Kosovë ka, por atyre duhet t'u epet mundësia e menaxhimit dhe e shpëtimit të kësaj ndërmarrje publike me rëndësi të veçantë kombëtare.

Të përfundojmë: Me bajraktarizmin e shtresuar në institucionet e Kosovës, me papërgjegjësinë institucionale të deritashme, me mosfunksionimin e Prokurorisë e të Gjyqësorit të Kosovës, shkurt me mosfunksionimin e shtetit të së drejtës, nuk zgjidhet asnjë problem me rëndësi kombëtare. Është e dhimbshme, por shumë zhvillime në shoqërinë shqiptare po tregojnë se kemi me shumë energji shkatërruese sesa ndërtojnë! Zhvillimet në Kosovë e Shqipëri janë tregues shqetësues për të ardhmen tonë të përbashkët.

Shkurt: Çdo problem ka zgjidhje sa herë kërkohet ajo! Por, ujqërit po kërkojnë mjegull!

Shala: Koha që problemet e eksporteve të Kosovës në Maqedoni të eliminohen

Prishtinë, 14 maj (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka zhvilluar një takim me ushtruesin e detyrës së ambasadorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Kosovë, Rexhep Saliu, në të cilin është diskutuar për marrëdhëniet në mes të dy shteteve dhe shkëmbimeve tregtare.

Ministri Shala e ka njoftuar ambasadorin Saliu për ankesat e bizneseve nga të dyja anët dhe, po ashtu, për barrierat që bizneset e Kosovës kanë gjatë eksportit në Maqedoninë e Veriut. "Mora zotimin nga ambasadori që këto barrierat jotarifore me Maqedoninë

e Veriut të eliminohen sa më shpejt që është e mundur. Unë jam i fokusuar që t'i ndihmoj biznesit vendor duke adresuar problemet e tyre dhe qëllimi i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është që prania e prodhimeve nga Kosova të rritet në vendet e rajonit dhe me gjerë, duke ndikuar në rritje të eksportit të prodhimeve tona", ka thënë Shala.

Ndërsa ushtruesi i detyrës së ambasadorit të Maqedonisë së Veriut në Kosovë, Rexhep Sali, ka shprehur gatishmërinë që të diskutohet për gjetjen e modaliteteve në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për t'i eliminuar barrierat.



Kosova ka përparuar ndjeshëm në reduktimin e armëve të vogla dhe të lehta



Izmi ZEKA,
zëvendësministër i
Ministrit të Punëve të
Brendshme (MPB)

Kontrolli i Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) është një ndër prioritetet për Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB). Ministria e Punëve të Brendshme është plotësisht e përkushtuar ndaj nisjes së fundit në fushën e AVL-ve, udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme për posedimin, keqpërdorimin dhe trafikimin e AVL-ve në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024.

Përhapja e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) në Republikën e Kosovës dhe posedimi i pakontrolluar paraqesin ende një kërcënim për jetën e njerëzve, rendin dhe sigurinë publike si dhe zhvillimin ekonomik.

Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e angazhuar në menaxhimin, kontrollin dhe luftën kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta si dhe eksplozivëve.

Që nga viti 2008 Republika e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, në veçanti UNDP-në, ka bërë përparim të dukshëm në fushën e kontrollit të AVL-ve. Arritjet e dukshme janë bërë në kuadrin institucional, kornizën legjislativë dhe zhvillimin e kapaciteteve. Korniza institucionale në Republikën e Kosovës gradualisht ndryshoi. Fillimisht kishim vetëm Komisionin Kombëtar i cili më pas u zgjerua në një rrjet operacional të institucioneve relevante dhe bashkëpunuese.

Institucionet kyçe relevante për kontrollin e AVL-ve

Sa i përket kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta dhe eksplozivëve, Republika e Kosovës zbaton një kornizë dhe strategji të gjerë ligjore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: Ligji nr. 04 /L-198 mbi Tregtinë e Mallrave Strategjike; Ligji nr. 04 /L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë; Ligji për 04 /L-022 Përdorimi Civil i Eksploziveve dhe 11 Udhëzimeve Administrative për zbatimin e këtij ligji; Ligji për Armët 05 /L-022 dhe 16 Udhëzime Administrative për zbatimin e këtij ligji; Ligji 03 /L-246 për Armët, Municionet dhe Pajisjet e Sigurisë së Lidhur me Institucionet e Autorizuara të Sigurisë Shtetërore

dhe 3 Udhëzimet Administrative për zbatimin e ligjit; Ligji për Gjueti; Ligji për Kontrollin e Kufirit Shtetëror; Ligji Nr. 05 /L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municioneve dhe Mjeteve Shpërthyes; Strategjia e Kontrollit dhe Grumbullimit të Armëve të Vogla dhe të Lehta. Pra, institucionet e Kosovës kanë krijuar mekanizma të përshtatshëm për zbatimin e legjislacionit që rregullon tregtinë, posedimin, ndjekjen, importin e armëve dhe eksplozivëve për sektorin privat dhe publik.

Shënimi dhe gjurmimi i armëve është funksional dhe është i standardeve të larta. Agjencia Forenzike e Kosovës është e pajisur me sistemin e teknologjisë IBIS (Integrated Ballistics Identification System) dhe gjeneron të dhëna inteligjente.

Në Policinë e Kosovës, Njësia Qendrore e Armëve të Zjarrit (FFP), që ndodhet në kuadër të Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit (ILECU), shërben si zyrë e inteligjencës, e cila punon në luftën kundër trafikut të paligjshëm të armëve.

FFP-ja gjurmon çdo armë të rikuperuar në nivel lokal, si dhe u përgjigjet kërkesave për gjurmim që parashtrihen. Përmes kësaj po përkrahen iniciativat për të avancuar aftësinë e Evropës Juglindore për të parandaluar dhe luftuar kriminalitetin e lidhur me armët e zjarrit dhe trafikimin e armëve.

Republika e Kosovës, në mënyrë të rregullt, merr pjesë në iniciativat rajonale që synojnë kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në rajonin e Evropës Juglindore, pra vendet e Ballkanit Perëndimor. Tregtia ilegale e armëve dhe municioneve, si dhe krimet me armë janë ulur ndjeshëm në krahasim me vitet e mëparshme. Institucionet e Kosovës kanë krijuar mekanizma adekuat për luftimin e trafikimit të paligjshëm dhe arritën në identifikimin e rrugëve kryesore të trafikimit.

Që nga viti 2008, Policia e Kosovës ka konfiskuar rreth 14 294 armë dhe 10 810 armë janë shkatërruar. Posedimi i armëve të paligjshme u zvogëlua me 34 për qind në mes të vitit 2005 dhe 2014, bazuar në të dhënat e mbledhura nga Anketa e Armëve të Vogla.

Sipas anketave, në Kosovë ka rreth 260 000 armë të paligjshme. Kjo tregon një reduktim të madh që nga vlerësimi i fundit i kryer në vitin 2007 (310 000 deri në 440 000 armë). Republika e Kosovës njihet si një vend me sukses të konsiderueshëm në përpjekjet e tyre në trajtimin e posedimit të armëve të paligjshme dhe largimin e armëve të paligjshme përmes konfiskimit, çaktivizimit dhe shkatërrimit të armëve.

Policia e Kosovës konfiskoi mijëra armë çdo vit. Po ashtu, gjurmimi

është mirë i rregulluar. Në Republikën e Kosovës gjurmimi rregullohet me Ligjin për Armët. Përgjegjësia institucionale e gjurmimit në Kosovë qëndron tek Njësia Qendrore e Armëve të Zjarrit (FFP), që ndodhet në kuadër të Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit (ILECU).

FFP-ja në Kosovë është vlerësuar si praktika më e mirë rajonale në Simpoziumin e Interpolitit për Forenzikë të Armëve të Zjarrit, duke u fokusuar në: Përpunimin dhe integrimin e të dhënave gjithëpërfshirë dhe të përditësuara të inteligjencës për armët e zjarrit dhe të inteligjencës balistike; Vlerësimet strategjike të inteligjencës që përkrahajnë shkallën dhe natyrën e kriminalitetit të lidhur me armët e zjarrit në Kosovë; Paketa të inteligjencës për hetime dhe operacione që synojnë kriminelët që përdorin armë zjarri; Zhvillimi i rekomandimeve për të shmangur dhe parandaluar kriminalitetin me armë zjarri; Sigurimi i një shërbimi ndërkombëtar të gjurmimit të armëve të zjarrit; Një pikë kontakti dhe Qendra e Ekspertizës për armët e zjarrit të partnerit dhe palët kombëtare dhe ndërkombëtare të interesit - pilot projekt për Ballkanin Perëndimor; FFP-ja në Kosovë është e vetmja në mbarë botën që ka qasje në informimin automatik nga të gjitha sistemet e kërkuara që përmblajnë informata balistike dhe kriminale; Zhvillimi i kapaciteteve në seksionin balistik, të zjarrit të qëllimshëm dhe eksplozivëve të Agjencisë Forenzike të Kosovës, përmes ofrimit të pajisjeve të specializuara dhe kurseve të specializuara (Sistemi i integruar i identifikimit balistik, mikroskopi elektronik skanues, pajisje me derdhje të dyfishtë, sistem shpejtësie plumbash, laborator qitjeje etj.)

Disa nga rezultate kyçe janë: zvogëlimi i numrit të armëve të paligjshme, vrasjeve, grabitjeve me armë, rritja e sigurisë fizike dhe menaxhimi i stokut etj., duke rezultuar në përmirësimin e sigurisë publike.

Gjatë periudhës 2008 - 2017 janë konfiskuar 14 294 armë dhe shkatërruar 10 810 sosh. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga Anketa e Armëve të Vogla, posedimi i armëve të paligjshme u zvogëlua për 34 për qind mes viteve 2005 dhe 2014. Nga viti 2013 deri në vitin 2015, shkalla e vrasjeve u zvogëlua për 50 për qind dhe vrasjet në tentativë për 16 për qind. Nga viti 2013 deri në vitin 2015 pati një zvogëlim prej 69 për qind të grabitjeve me armë.

Janë zhvilluar standardet e menaxhimit të stoqeve për individë, për persona juridikë të angazhuar në tregtinë e armëve, si dhe për institucionet e autorizuara të sigurisë. Janë përmirësuar stoqet e ndryshme, të cilat tashmë përbushin standard-

et e Udhëzimeve Teknike Ndërkombëtare për Municionet, duke përfshirë Licencat për Kufizimin e Eksplozivit.

Sfidat dhe rruga përpara

Pavarësisht përmirësimeve në fushën e Armëve të Vogla dhe të Lehta, përhapja e AVL-ve në Kosovë është ende një sfidë për institucionet e sigurisë. Sipas sondazheve, gati një në shtatë qytetarë të Kosovës posedojnë armë ilegale, ndërsa për shkak të dhunës me armë zjarri gjatë vitit 2015, pesëmbëdhjetë vetë humbën jetën.

Gjatë vitit 2015, në pajtim me Kodin Penal të Kosovës, janë raportuar 1 500 raste të krimeve të kryera duke përfshirë armët e zjarrit të raportuara në Policinë e Kosovës.

Për më tepër, sfidë për institucionet tona është zbatimi i Ligjit Nr. 05 / L-134 për Legalizimin dhe Dorëzimin e Armëve, Municioneve dhe Pajisjeve Eksplozive.

Ky proces do të kërkojë planifikim të duhur dhe partneritet me aktorët ndërkombëtarë, sektorin privat dhe komunitetin për të arritur sukses në reduktimin e numrit të armëve të paligjshme, në njërin anë, si dhe reduktimin e kërkesës për posedim të armëve, nga ana tjetër.

Procesi i legalizimit

Armët

1. Arma duhet t'i përkasë kategorisë së lejuar për legalizim, B, C dhe D për qëllimet e parashikuara në kuadër të Ligjit për Armët (shenjëtari, gjueti, koleksion etj...) kurse kategoritë A2 dhe A16 vetëm për çaktivizim;

2. Arma nuk paraqet rrezik për sigurinë publike;

3. Arma nuk i takon askujt tjetër.

Qytetari

1. Qytetari duhet të ketë moshën mbi 21 vjeç;

2. Të ketë kartë identiteti të Kosovës ose të ketë leje të përhershme qëndrimi;

3. Të MOS paraqesë rrezik për sigurinë publike.

Procesi i legalizimit

1. Pala duhet të paraqitet në stacionin policor më të afërt me vendbanimin apo vendqëndrimin e tij dhe të deklarojë posedimin e armës, të cilën nuk e ka regjistruar më parë, me ç'rast, i njëjti pajiset me librezë;

2. Pala është e obliguar që të dërgojë armën te personi juridik i licencuar, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të librezës;

3. Personi juridik i licencuar është i obliguar që, brenda dy (2) ditëve pas pranimit të armës, të verifikojë që arma nuk paraqet rrezik për sigurinë publike, të bëjë testin e gjuajtjes dhe të verifikojë nëse arma është shën-

juar sipas Nenit 56 të Ligjit mbi Armët 05/L-022 dhe Nenit 5 të Ligjit nr. 05/L - 134 për legalizimin dhe dorëzimin e armëve, municionit dhe mjeteve shpërthyes;

4. Në rast se personi juridik i licencuar vërteton se janë përmblusur kushtet teknike të armës, organi kompetent e aprovon aplikacionin, palës jepet pëlqimi (me afat 1 vjeçar) nga stacioni policor për përfundimin e procesit të legalizimit dhe i njëjti mund ta marrë armën e cila do të shënjohej si armë e legalizuar sipas nenit 56 të Ligjit për Armë.

5. Me rastin e marrjes së pëlqimit njëvjeçar (periudha kalimtare), aplikuesi nënshkruan edhe marrëveshjen e pajtueshmërisë e cila thotë që:

a) gjatë periudhës njëvjeçare aplikuesi duhet t'i plotësojë të gjitha kriteret sipas Ligjit për Armë, me qëllim të marrjes së lejes përkatëse;

b) gjatë periudhës njëvjeçare arma verifikohet në bazat e të dhënave përkatëse të forenzikës dhe, nëse konstatohet që arma është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, organi kompetent informon pronarin rreth dorëzimit të armës;

6. Gjatë periudhës kalimtare sipas paragrafit 12 (Nenit 56 të Ligjit mbi Armët 05/L-022), arma nuk mund të përdoret, të transportohet, të shitet apo për të njëjtën të blihet municion.

E rëndësishme është që gjatë periudhës së legalizimit, të shpallur me vendim 536/2018, do të pezullohet zbatimi i nenit 374 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

MPB-ja pas hapjes së procesit është duke analizuar në vazhdimësi procesin dhe mbi bazë të saj po ndërmer hapat e nevojshëm. Fushata "Me Letra" intensifikohet me qëllim të informimit të drejtë të qytetarëve tanë anembanë.

Me lejon që shkurt të rritet kostoja e Kosovës është një vend i sigurt dhe në fushën e AVL-ve ndërmerr hapat e nevojshëm. Sa i përket trafikimit të armëve, Kosova ka miratuar dhe po zbaton strategjinë e saj për armët e vogla dhe të lehta dhe kontrollin e eksplozivit 2017 - 2021.

Ligji për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve dhe materialeve shpërthyes është edhe një mekanizëm shtesë sa i përket rritjes së sigurisë për vetë qytetarët.

Prandaj, periudha prej gjashtë muajsh për legalizimin e armëve, që ka filluar nga data 17 dhjetor 2018 dhe përfundon më 17 qershor 2019, u ka dhënë shansin qytetarëve të Republikës së Kosovës që të shfrytëzojnë këtë mundësi.

Tanimë kanë mbetur edhe një muaj kohë deri në përfundimin e këtij procesi, të legalizimit të Armëve të Vogla dhe të Lehta, dhe ftoj qytetarët që ta shfrytëzojnë edhe këtë periudhë kohore që të kontribuojnë në rritjen e sigurisë në vend.

VUÇIÇ E DËGJON FJALIMIN SHQIP NË PARLAMENT



Ismet SYLEJMANI

Inaugurimi i Presidentit të një vendi në rrethana normale do të duhej të ishte ngjarje vetëm e atij vendi dhe lajm për mjetet e informimit dhe informacione të domosdoshme të ambasadorëve dhe konsujve për vendet e tyre!

Por seanca plenare e Parlamentit të Maqedonisë së Veriut e datës 12 Maj 2019 në Shkup, për inaugurimin e Presidentit të posazgjedhur Stevo Pendarovski është ngjarje që i tejkalon kufijtë normal të një inaugurimi shtetëror e kombëtar, pasi aty në një event ka shumë permasë ndikimi, sepse është rast për histori dhe memorie njerëzore, shtetërore e politike kombëtare e ndërkombëtare!

Presidenti Pendarovski pas fitores që arriti për të qenë Presidenti i parë konsensual dhe i pari i Maqedonisë së Veriut pas ndryshimit të emrit, e i 5-ti pas shkatrrimit të ish-Jugosllavisë dhe ndryshimit të emrit të FYROM, ai po bëhet edhe Presidenti i parë që në inaugurimin presidencial e dëgjon ai dhe i gjithë opinioni brenda e jashtë, se si Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, shqiptari legjendar Talat Xhaferi mban fjalimin historik në gjuhën shqipe!

Në këtë ngjarje të madhe historike në Maqedoninë e Veriut, kishte shumë personalitete që morrën pjesë, që ishin të detyruar të merrnin pjesë dhe nga ata që me padurim e prisnin dhe ishin të lumtur që merrnin pjesë!

Ndër ata që ishin të detyruar të merrnin pjesë ishin Presidenti në largim i Maqedonisë së Veriut Gjorgje Ivanov dhe Presidenti i Serbisë Aleksander Vuçiç!

I pari ishte i detyruar patjetër të kryente detyren shtetërore që i kërkohet me kushtetutë dhe ligj dhe i dyti ishte i detyruar të merrte pjesë për shkaqe historike, sepse në të kaluarën

Maqedonia kishte qenë poligoni antishqiptar, ku ish-Jugosllavia përkatësisht Serbia kishte bërë investime e projekte të mëdha në dëm të popullit shqiptar dhe çështjes së tij! Politika shfarosëse e kraljëve serb, elaboratet e shfarosjes të qubrilloviqëve, pashiqëve, karagjorgjeviqëve dhe nediqëve, mbretërve, presidentëve dhe kryeministrave të ndryshëm famëkqinjë, kriminel e gjakpirës të zinjë si katrani, kishin bërë të gjitha

Populli shqiptar pasardhës i denjë i kryeheronjëve e kryeudhëheqësve të lavdishëm të Atdheut e të Kombit tonë, në shekullin modern të njerëzimit, konkretisht më 12 Maj 2019, shënoi një rën nga fitoret e mëdha të tij, pasi e detyroi të bien në gjunj çdo armik e kundërshtarë të tij, duke e nxjerrë me madhësi e heroizëm në podium, njërin prej bijëve të mëdhenj të tij, ish - Komandantin e Brigadës së UÇK-së, ish-Ministrin e

lit shqiptar Ali Ahmeti! Njëri prej pjesmarrësve të drejtëpërdrejtë në cilësinë e të ftuarit të seancës inauguruese të presidentit të ri të Maqedonisë së Veriut ishte edhe Presidenti i Serbisë Aleksander Vuçiç! Ky antishqiptar i madh e i përbetuar, ky armik i deklaruar i Kosovës, ky pasardhës i denjë i të gjitha figurave antishqiptare në përgjithësi dhe i atyre kundër Kosovës e Viseve shqiptare në ish-Jugosllavi, his-

Maqedoninë e Veriut, atje në Manastirin e lashtë!

Shihite qudine shqiptare në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut!

Dëgjonte në panik shpirtërorë e moral, se si gjëmonte shqipja fitimtare e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare!

Shihite e dëgjonte pasardhësi i kriminelit e xhelatit Milosheviq, Sheshel e Arkan, se si është demokratizuar nga fryma e madhe euroatlantike Maqedonia e Veriut!

E dinte Presidenti i Serbisë se në sallën e parlamentit i ulur ishte deputeti i popullit shqiptar, Udhëheqesi i madh e i lavdishëm, ilegali i famshëm e njëri prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Ali Ahmeti!

Aty në sallën e Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, ishte Udhëheqesi Ali Ahmeti me shokët e bashkpunëtorët e Tij, deputetët besnik e të panështruar të popullit shqiptar!

Kjo është politika e madhe shqiptare, kjo është strategjia e madhe e suksesit e kombit tonë, kjo është fitorja e arrirë e shkuarve që qindra dhe mijëra shqiptarë të gjeneratave të ndryshme dhanë për Atdheun! Presidenti i Serbisë Aleksander Vuçiç duhet ti bindë jo vetëm sytë e veshët e Tij, por edhe mendjen e zemrën, se pa shqiptarët dhe kundër shqiptarëve Serbia, gjithmonë do jetë e trazuar, do të jetë me probleme, do të jete në kudhrën e goditjeve të miqve e partnerëve tanë të mëdhenj ndërkombëtarë!

Sa më shpejtë që ta kuptojë se duhet jo vetem të kërkohet falje e të kompensojë dëmet e mëdha të luftës që ia ka shkaktuar Serbia popullit shqiptar në Kosovë, do të jetë fillimi i stabilizimit e normalizimit të realitetit të ri në Kosovë e Ballkan!

Duhet të bindet sepse duhet ta ketë të qartë, ashtu sikur i kanë ushtuar veshët nga fjalimi në gjuhën shqipe i Kryetarit të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut Talat Xhaferi, ushtimë, rrëmuje e piskamë do ta ketë kudo, derisa ta njohë e pranojë ndërkombëtarisht realitetin e ri me Kosovën e lirë e sovranë, të pavaruar e përgjithmonë jashtë kufinjve politik të Serbisë!

Prishtinë, më 13 Maj 2019!



vprimet e lejuara dhe të palejuara, njerëzore dhe antinjerëzore, për të zhbërë çdo gjë shqiptare në Ballkan dhe për ta realizuar praktiken dhe ëndrën shekullore të pashallarëve turq, për ta pastruar Europen nga shqiptarët për inatë të faktit të madh, pasi shqiptarët u bënë pengesë e pakalueshme për marshim të osmanllinjëve në drejtim të zemrës e qendrës së katolicizmit të Europës, së paku shqiptarët të asimiloheshin!

Mbrojtjes të Maqedonisë, Kryetarin e Parlamentit të Maqedonisë së Veriut Talat Xhaferin i cili në seancën inauguruese të Presidentit Pendarovski mbajti fjalimin shqip, ashtu sikur e njeh ligji, ligj i cili u arrit falë gjakut të derdhur për liri të Heronjëve dhe Dëshmorëve, falë luftës shekullore të përfunduar me emblemën e shenjtë dhe të shtrenjtë të UÇK-së dhe falë udhëheqjes titanike të Udhëheqësit të madh të popul-

torikisht ishte i dënuar të shihet dhe të dëgjonte se si në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë, populli shqiptarë është bërë zot i fateve të veta, dhe se përfaqesuesi e biri i madh i kombit tonë, Talat Xhaferi, në cilësinë e Kryetarit të Parlamentit drejtonte seancën solemne inauguruese të Presidentit të ri të Maqedonisë së Veriut Stevo Pendarovskit në gjuhën shqipe, të kësaj gjuhe hyjnore e cila vendlindjen e sajë e ka në

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"

 TEL: 045 82 82 82

Llapi kërkon fitore për vend të dytë, 'Nikli' për titull

Trajneri Tahir Batatina ka paralajmëruar se Llapi kërkon fitore ndaj Feronikelit për të mbetur në garë për pozitën e dytë në tabelë. "Si në çdo ndeshje tjetër, Llapi hyn për fitore edhe në ndeshjen ndaj Feronikelit, e cila do të jetë e vështirë për të dy klubet. Synimi ynë është që të fitojmë dhe të mbesim në garë për pozitën e dytë në tabelë për faktin se Feronikeli është në garë për të dy trofetë. Mungesa të rëndësishme për ndeshjen e radhës i kemi Benjamin Eminin dhe Valmir Veliun", ka thënë Batatina

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 MAJ - Skuadra e Llapit, pas humbjes në minutat e fundit në derbin ndaj Prishtinës, kërkon fitore sot (e mërkurë) në derbin e xhiros së parafundit në IPKO Superligë ndaj Feronikelit. Këto dy skuadra takohen sot nga ora 16:00 në stadiumin "Zahir Pajaziti", ku edhe mund të vendoset titulli i kampionit.

Trajneri Tahir Batatina ka thënë të martën për "Epokën e re" se Llapi synon fitore për t'i ruajtur shpresat për pozitën e dytë. "Si në çdo ndeshje tjetër, Llapi hyn për fitore edhe në ndeshjen ndaj Feronikelit, e cila do të jetë e vështirë për të dy klubet. Synimi ynë është të fitojmë dhe të mbesim në garë për pozitën e dytë në tabelë për faktin se Feronikeli është në garë për të dy trofetë. Mungesa të rëndësishme për



ndeshjen e radhës i kemi Benjamin Eminin dhe Valmir Veliun", ka thënë Batatina. Feronikeli në ndeshjen e fundit u tregua skuadër bindëse ndaj Dritës, duke e mposhtur 4-1 në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Për fitore, sipas Astrit Fazliut, "Nikli" do të luajë edhe ndaj Llapit, në ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë. "Ne jemi mirë të përgatitur për ndeshjet e fundit. Të gjithë e dimë rëndësinë e pikëve si për ne, po ashtu edhe për Llapin, por Feronikeli, si në çdo ndeshje tjetër, udhëton për fitore. Kundërshtari ka skuadër cilësore dhe do

të jetë ndeshje e vështirë për të dy klubet dhe interesante për publikun", ka thënë Fazliu, i cili ka konfirmuar se "Nikli" në këtë ndeshje nuk do të ketë mungesa. Në rast se "Nikli" shënon fitore do të jetë kampion sipas të gjitha gjasave, kurse me barazim dhe me fitore të Prishtinës ndaj Trepçës '89 mbetet në pozitën e parë, por me pikë të barabarta me kryeqytetasit. Interesante pritet të jenë edhe dy ndeshjet e tjera që zhvillohen sot: Drita-Flamurtari dhe Drenica-Ballkani. Dy ndeshjet fundit për këtë xhiro zhvillohen të enjten, kurse takohen: Gjilani-Liria dhe KEK-u-Ferizaj.

IPKO SUPERLIGA - JAVA E 32-TË

Të mërkurën takohen:
 Prishtina - Trepça '89
 Llapi - Feronikeli
 Drita - Flamurtari
 Drenica - Ballkani

Të enjten takohen:
 Gjilani - Liria
 KEK-u - Ferizaj

LIGA E PARË - Java e 29

Besa - Arbëria
 Vushtrria - Ramiz Sadiku
 Trepça - Kika
 Istogu - Vëllaznimi
 Drenasi - Fushë Kosova
 Vitia - Vllaznia (P)
 2 Korriku - Dukagjini
 Bashkimi (K) - Onix

SHKURT

FBK-ja dënon KB Rahovecin

Federata e Basketbollit e Kosovës e ka dënuar KB Rahoveci me 2 600 euro për shkak se në ndeshjen finale tifozët vendës kanë hyrë në parket. Këtë lajm e ka konfirmuar Klubi i Rahovecit përmes faqes zyrtare në "Facebook". "2 600 euro dënime dhe dy ndeshje pa praninë e publikut është bilanci i dënimeve që skuadra jonë ka marrë nga FBK-ja pas zhvillimeve që ndodhën në ndeshjen e fundit. Bordi i KB Rahoveci do ta apelojë këtë vendim dhe në rast të refuzimit atëherë jemi të detyruar që dy ndeshjet hapëse të sezonit të ri t'i luajmë pa prani të shikuesve. Me këtë rast kërkojmë nga të gjithë dhe shpresojmë të mos përsëriten më veprimet e tilla të cilat më së shumti shkojnë në dëm të klubit, por edhe qytetit në përgjithësi", thuhet në njoftimin e KB Rahoveci.

Skomina, gjyqtari i finales Tottenham - Liverpool

Është vendosur se kush do të jetë gjyqtari që do ta gjykojë finalen e Ligës së Kampionëve mes Tottenhamit dhe Liverpoolit. Në derbin anglez ai që do të vendosë drejtësi do të jetë 42-vjeçari sloven Damir Skomina. Finalja do të zhvillohet më 1 qershor në Madrid. "Wanda Metropolitan" do të jetë arena pritëse. Asistentët e slovenit do të jenë Juri Praprotnik dhe Robert Vukan. Ndërkohë që i katërti do të jetë Lahoz nga Spanja. Skomina ka stemën e FIFA-s që prej vitit 2003.

Në fundjavë nis faza e 'play-off'-it në futsall

Garat e rregullta në Superligën e futsallit tashmë kanë përfunduar dhe dihen katër skuadrat të cilat do t'i vazhdojnë garat në "play-off". Në mesin e katër skuadrave që do të luftojnë për titull janë Mabetex Prishtina, Liburni, Besa dhe Malisheva. Kjo e fundit në fund të kampionatit të rregullt kishte pikë të barabarta me Pejën, por falë bilancit më të mirë në ndeshjet e ndërsjella e ka siguruar kalimin tutje. Në gjysmëfinale të "play-off"-it, Mabetex Prishtina do të luajë kundër Besës, derisa Liburni do të përballet me Malishevën. Seria e ndeshjeve të "play-off"-it nis në fundjavën e ardhshme. Ndërkohë nga Superliga ka rënë Mitrovica, kurse pjesëmarrjen në elitën e futsallit për edicionin e ardhshëm e kanë siguruar Prishtina 01 dhe BB Llapi, që e kanë përmbyllur kampionatin në Ligën e Parë në dy pozitë të para.

Taekwondistët synojnë medalje në 'Manchester 2019'

PRISHTINË, 14 MAJ - Katër garues të sportit të taekwondosë do të përfaqësojnë Kosovën në Kampionatin Botëror të Taekwondosë që mbahet nga sot (e mërkurë) deri më 18 maj në Manchester të Anglisë.

Qëndrim Sejfiqaj, kategoria deri në 68 kilogramë, Butrint Ejupi, kategoria deri në 74 kilogramë, Natyra Kadriu (-46 kg) dhe Don Berisha (+87 kg), do të synojnë të lënë gjurmë në botëror, bashkë me trajnerin e kom-

bëtares Arsim Agushi. Sekretari i përgjithshëm i Federatës së Taekwondosë së Kosovës, Enis Qafëlleshi, thekson se në Manchester udhëtojnë për të mos u kthyer duarthatë. "Kjo është hera e tretë që

taekwondistët marrin pjesë në botëror, pas pjesëmarrjes në Rusi dhe Kore të Jugut. Pretendimet nga Manchesteri i kemi për medalje", shprehet me optimizëm Qafëlleshi për uebfaqen zyrtare të KOK-ut.



De Rossi largohet nga Roma pas 18 vjetësh

ROMË, 14 MAJ - Daniele De Rossi është një ndër lojtarët legjendë të Romës, me italianin që është pjesë e verdhekuqve prej plot 18 vjetësh. Mesfushori është shndërruar në një ikonë të kryeqytetasve,

duke ndjekur hapat e Francesco Tottit. Gjithsesi, tashmë De Rossi numëron plot 35 vjet mbi supë dhe duket se rrugëtimi i tij me Romën ka shkuar drejt fundit. Ka qenë vetë klubi verdhekuq

që ka publikuar vendimin zyrtar për sa i përket De Rossit, i cili në fund të këtij sezoni e mbyll aventurën në Itali. Sidoqoftë, kapiteni nuk do ta mbyllë me futbollin e luajtur. Sipas klubit të Romës,

De Rossi mund të transferohet në ShBA sipas gjasave, ku do ta vijojë karrierën në MLS. De Rossi ka fituar dy Kupa si dhe një Superkupë, teksa ka luajtur 613 ndeshje në total, duke shënuar 63 gola.



Në kërkim të finales

Katër skuadrat elitare të hendbollit në konkurrencën e meshkujve Besa dhe Kastrioti dhe në konkurrencën e femrave Istogu dhe Vushtrria sot (e mërkurë) kërkojnë kualifikimin në finale

PRISHTINË, 14 MAJ - Pasi ka fituar bindshëm ndeshjen e parë gjysmëfinale, Besa Famgas sot (e mërkurë) mund ta sigurojë kalimin në finale të "play-off"-it të Superligës së Kosovës në hendboll. Në Gjakovë nga ora 19:00 luhet ndeshja në mes të Vëllaznimit dhe Besa Famgasit. Skuadra pejane është kampione aktuale dhe e ka përfunduar Superligën A në vend të parë. Ndeshjen e parë të luajtur të shtunën në Pejë, Besa e fitoi me rezultat 39:10. I duhet edhe një fitore apo barazim për të kaluar në finale. Ndërsa skuadra e Vëllaznimit e ka mbyllur Superligën A në vend të katërt. Sot (e mërkurë) luhet edhe gjysmëfinalja e dytë e "play-off"-it në mes të Prishtinës e Kastriotit. Kjo ndeshje luhet në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve nga ora 18:00. Ndeshjen e parë të luajtur të shtunën në Ferizaj e ka fituar Kastrioti me rezultat 28:21. Kastrioti ishte i dyti në Superligën A, ndërsa Prishtina e treta. Ndeshje e fortë e cilësore pritët të jetë në kryeqytet. Kastrioti do të mundohet që me fitore apo barazim ta sigurojë finalen, ndërsa Prishtina



që ta barazojë rezultatin në 1:1 dhe ta sigurojë edhe ndeshjen e tretë që do të luhej në fundjavë në Ferizaj. Sot (e mërkurë) zhvillohen edhe gjysmëfinalët e dyta të "play-off"-it edhe në Superligën e hendbollisteve. Nga ora 15:00 në Gjakovë takohen Shqiponja e Istogu, kurse një orë më vonë luhet takimi Prishtina-Vushtrria. Ndeshjet e para janë fituar nga Istogu e Vushtrria që me fitore apo barazime në ndeshjet e të mërkurës kalojnë në finale. Të

shtunën, Istogu në Pejë fitoi ndaj Shqiponjës me rezultat 35:26, ndërsa Vushtrria të njëjtën ditë e mposhti Prishtinën me rezultat 26:19. Kështu, në ndeshjet e dyta Istogu e Vushtrria synojnë kalimin në finale, ndërsa Shqiponja e Prishtina ta barazojnë rezultatin në 1:1 me ndeshje dhe t'i sigurojnë ndeshjet e treta e vendimtare. Në stinorin e rregullt Istogu ishte i pari, i përcjell nga Vushtrria, Prishtina e Shqiponja, që është kampione aktuale.

Përcaktohen finalistet e Konferencave në NBA

Portland, 14 maj - Në NBA janë dhënë verdiktet e fundit sa i përket fazës së gjysmëfinaleve të "play off"-eve. Në Konferencën e Perëndimit skuadra që do të vihet përballë Golden State është Portlandi, që fitoi ndeshjen e 7 ndaj Denverit në "Pepsi Center" me rezultat 100-96, duke e mbyllur serinë e ndeshjeve në 4-3. Njeriu i ndeshjes për "Trailblazers" u bë CJ McCollum, me 37 pikë personale të shënuara. Ishte një ndeshje disi nervoze, pasi të dyja skuadrat zbritën në parket me idenë që nuk mund të gabonin. Fillimi ishte më i mirë për Denverin, që e mbylli periodën e parë 29-17. Me kalimin e minutave kjo diferencë u rrit, me "Nuggets"-in që e çoi në 17 pikë në një moment. Por, pas pushimit të ndeshjes, situata ndryshoi krejtësisht, me Portlandin që besoi te McCollum, i cili ishte në një ditë fantastike, ndërkohë që te Denveri filloi të shfaqej frika. Ishin 12 minuta e fundit të sfidës ato që vendosën fatin e saj, me Portlandin që bëri më mirë, duke siguruar finalen



e Konferencës së Perëndimit që i mungonte nga viti 2000, raporton "tch". Në Konferencën e Lindjes ishte Toronto që preu biletën për në finale, pasi mundi Philadelphia 92-90 në një ndeshje me emocione të forta. Në "Scotiabank Arena" të Torontos në parket u panë dy skuadra që luftuan në çdo moment të sfidës, nga fillimi deri në fundin e saj. Ai që vendosi fatin e saj në favor të skuadrës kanadeze ishte Leonardo,

kur kishin mbetur 4.2 sekonda nga fundi i sfidës dhe rezultati ishte i barabartë. Leonardo mori topin nga rivënia, shkoi drejt këndit për ta bërë gjuajtjen e tij pikërisht në momentin që do të dëgjohej sirena, duke u treguar i saktë për t'i dhënë goditjen e fortë Philadelphia e për ta çuar skuadrën e tij në finale, ku e pret skuadra e Milwaukee Bucksit. Një finale kjo që premtion spektakël, pjesë e së cilës do të jetë edhe sfida Leonard-Antetokounmpo.

SHKURT

PSG-ja, 210 milionë euro për tre lojtarë të Realit

PSG-ja është duke u interesuar për tre kampione në largim nga Realit i Madridit. Planit është për të shpenzuar 210 milionë euro për t'i transferuar në kryeqytetin francez, Gareth Bale, Iscon dhe Toni Kroosin. Sulmuesi uellsian, i cili vlerësohet 70 milionë euro, i ka prishur marrëdhëniet me trajnerin Zinedine Zidane, që e ka "përrjashtuar" nga organika, duke mos e grumbulluar në ndeshjet e fundit të La Ligës, ndërsa mesfushorët, që vlerësohen 60 milionë i pari (Isco) dhe 80 milionë i dyti (Kroos), nuk kanë përfutuar nga mundësitë që ua ka ofruar trajneri francez.

Unitedi synon transferimin e Koulibalyt

Manchester Unitedi e ka caktuar qendërmbrojtësin e Napolit, Kalidou Koulibaly, si cakun kryesor për ta transferuar këtë verë. Megjithatë, sipas "Daily Mirror", Unitedi do të duhet të thyejë rekorde për ta transferuar mbrojtësin. Presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, më parë kishte thënë se e kishte refuzuar një ofertë 100 milionë euro për 27-vjeçarin dhe se klubet angleze duhet të ofrojnë më shumë. Shifra më e lartë për transferimin e një qendërmbrojtësi deri tash mbetet ajo e vitit 2018 kur Liverpooli transferoi Virgil Van Dijkun nga Southamptoni për 75 milionë euro.

Robbeni refuzon transferimin në Kinë

Ylli holandez, Arjen Robben, do të largohet nga Bayern Muncheni në fund të këtij edicioni. 35-vjeçari që është pjesë e Bayernit që dhjetë vjet ka refuzuar transferimin në Kinë, pasi ende dëshiron të luajë në nivele të larta. "Dua të vazhdoj të luaj. E rëndësishme është që nuk do të humbas pesë muaj. Në karrierën time gjithmonë kam luajtur në nivelet më të larta. Kam shumë oferta në Evropë, por jo vetëm. Por, e sigurt është se e ardhmja ime nuk do të jetë në Kinë", ka thënë Robbeni.

Mahrezi nuk largohet nga Manchester City

Futbollisti Riyad Mahrez nuk do të largohet gjatë verës nga Manchester City edhe përkundër se nuk po luan rregullisht. Kohët e fundit është folur për një largim të tij nga City, por ish-futbollisti i Leicester City dëshiron të mbetet pjesë e skuadrës nga "Etihad Stadium" dhe në edicionin e ri ta fitojë besimin e plotë të trajnerit Pep Guardiola. Mahrezi shënoi një nga golat e fitores se Manchester Cityt në ndeshjen e fundit ndaj Brightonit.

Spalletti kritikon gazetarët italianë

Trajneri i Interit, Luciano Spalletti, ka goditur rëndë gazetaret italiane për raportimet se Antonio Conte do ta zëvendësojë atë te klubi i Serisë A. "Për tre muaj, të njëjtat gjëra janë thënë, 'La Gazzetta dello Sport' ka shkruar të njëjtën gjë për tre muaj. Nëse dikush thotë se do të bjerë shi çdo ditë, përfundimisht ndoshta do të bjerë shi", ka thënë Spalletti. "Ju vazhdoni të më kërkonit të njëjtat gjëra çdo javë dhe unë nuk dua të jem i vrazhdë duke mos ju përgjigjur. Nëse 'La Gazzetta dello Sport' ka shkruar të njëjtën gjë për dy vjet, dhe gjatë tre muajve të fundit shkruante çdo ditë, atëherë ajo duhet të dijë diçka", ka deklaruar Spalletti.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš / Dragas Municipality



Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, neni 4, paragrafi 5 dhe neni 15, kërkeses nga drejtori për Administratë nr.02.111/01-10355, aprovimit nga kryetari i komunes, Shërbimi i Personelit K.Dragash, shpall:

KONKURS **Për minoritete**

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i Gjendjes Civile në ZGJC Brod
Njësia: Shërbimi i Gjendjes Civile
Niveli i pages: Koeficienti: 5
Orari i punës: Me orar të plotë (40 orë në javë)
Kohëzgjatja e kontratës: Me afat të caktuar deri në kthimin e nëpunësit
I raporton: Shefit të Zyres së Gjendjes Civile dhe Drejtorit të Administratës
Detyrat dhe përgjegjësitë

- Zhvillim dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me udhëheqësin për zbatimin e objektivave në realizimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në fushën e gjendjes civile.
- Shqyrton kërkesat e palëve dhe përgatit aktvendime për korrigjimin e gabimeve të cilat kanë ndodhur me rastin e regjistrimit në librat amzë, aktvendime lidhur me ndërrimin e emrit, të mbiemrit dhe regjistrime të mëvonshme në librat amzë të lindurve;
- Bënë regjistrimin e ngjarjeve të gjendjes civile në librat amzë përkatës;
- Merr pjesë në grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet;
- Ofron këshilla në fushën e ekspertizës së kërkuara brenda institucionit;
- Raporton rregullisht të Udhëheqësi për detyrat e kryera sipas planit.
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi:

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare pa përvojë ose shkollë e lartë dhe së paku dy (2) vite përvojë pune.
- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit universitar;
- Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës;
- Aftësia për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar stafin e nivelit administrativ;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike dhe të vlerësimit të informacionit;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Afati i Konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 nga dita e shpalljes, kërkesat e parashtuara pas këtij afati nuk do të pranohen. Aplikacionet për aplikim merren në zyrën e Shërbimit të Personelit nr.9 K.Dragash.

Sherbimi i Personelit

V.Ek.nr. 139/17

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjykatësin Faton Bajrami, në çështjen juridike të paditësit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Pyjeve të Kosovës –Drejtoria Koordinues- Prizren, kundër të paditurve Kos-it me seli në Prishtinë, tani me adrese të panjohur dhe KS "Siguria" me seli në Prishtinë, baza e kontestit: Borxh, me datë 06.05.2019, morri këtë:


AKTVENDIM

Për përfaqësues të përkohshëm të paditurit të pare Kos-it me seli në Prishtinë, tani me adrese të panjohur i caktohet Nexhat Sylva avokat nga Prishtina i cili do të kryej të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, deri sa i padituri ose përfaqësuesi i tij nuk lajmërohet-paraqitet në këtë gjykatë, respektivisht deri sa Organi i kujdestarisë nuk i cakton kujdestar.

Arsyetim

Meqenëse komunikimi me të paditurin nuk është i mundur, duke pas parasysh nga fletë kthesat (ku është konstatuar se selia e të paditurit është e mbyllur), e po ashtu edhe nga njoftimi i ARBK-se, rezulton se adresa e të paditurit është e njëjtë me atë të cilën gjykata ka komunikuar deri me tani, ndërsa për gjykatën është e paarritshme sigurimi i tij, ashtu që për këtë palë kishin me pësuar pasoja në procedurë, gjykata të paditurit e pare i ka caktuar përfaqësues të përkohshëm- i cili do të kryej të drejtat dhe obligimet e përfaqësuesit ligjor, për deri sa i padituri, ose përfaqësuesi i tij nuk paraqitet në këtë gjykatë, respektivisht deri sa Organi i kujdestarisë nuk i cakton kujdestar, lidhur me këtë gjykata ka vendos duke e aplikuar nenin 79.3 pika a të LPK-se.

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE
Departamenti për Çështje Ekonomike
V.Ek.nr. 139/17 date 06.05.2019



KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/ Dragas Municipality



Na osnovu Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo, Uredba br. 02/2010 o procedurama zapošljavanja državnih službenika, član 4, stav 5 i član 15, zahteva od strane direktora Administracije br 02.111/01-10355, odobrenje od strane predsednika opštine, Kadrovska služba pri SO Dragaš objavljuje:

KONKURS **Za manjine**

Naziv radnog mesta: Službenik civilnog stanja uMS- Brod
Odsek: Služba civilnog stanja
Nivo plate: Koeficijentat 5
Radno vreme: Puno radno vreme (40 sati nedeljno)
Trajanje ugovora: Sa određenim rokom do povratka službenika
Izvestava: Šefu kancelarije Civilnog Stanja i Direktoru Administracije

Zadaci i odgovornosti:

- Odvija i uspeva usaglašava radne planove i rokove sa rukovodstvom za sprovođenje objektivna u realizovanju usluga za građane u oblasti civilnog stanja;
- Razmatra zahteve stranaka i priprema Rešenje za popravke grešaka koje su se desile tokom registriranja u matičnim knjigama, Rešenje o promeni imena i prezimena i naknadno registrowanjem u matičnim rođenim knjigama;
- Obavlja registrowanje zbiljanja u civilnoj službi u konkretnim matičnim knjigama;
- Učestvuje u radnim grupama u profesionalnom oblasti kada se to zatraži;
- Daje savete iz oblasti ekspertize tražene iz institucija;
- Izveštava redovno kod rukovodioca za zadatke obavljene prema planu;
- Obavlja i ostale radove u skladu sa zakonima i Uredbama koje se mogu tražiti opravdano povremeno od nadležnog;

Kvalifikacija i potrebne veštine:

- Univerzitetska diploma, bez iskustva ili višu školu i najmanje dve (2) godine radnog iskustva
- Specifična stručna znanja u relevantnoj oblasti rada, stečeno kroz univerzitetsko obrazovanje
- Sposobnosti rešavanje problema iz tehničkih poslova ili proceduralnih problema koji su u toku procesu rada;
- Sposobnost da organizuje svoj rad i da koordinira osoblje administrativnog nivoa;
- Sposobnosti istraživanja, analize i procenjivanja informacija;
- Dobro poznavanje rad sa kompjuterom (Word, Excel, Power Point, Access);

Rok Konkursa: Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja, podneseni zahtevi nakon ovog roka neće biti prihvaćeni. Obrazac za prijavu možete dobiti u Kancelariji za Kadrovsku službu br.9. O.Dragas.

Kadrovska Sluzba

Translation from Albanian into English

REPUBLIC OF KOSOVO
Government
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
Kosovo Forest Agency
No 255/19
On 13.05.2019
Office in Prizren

V. Ek. No 139/17

COMMERCIAL COURT OF PRISTINA, Department of Commercial Affairs, with the judge Faton Bajrami, in the legal case of the claimant, Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development, Kosovo Forest Agency, Coordination Directorate - Prizren, against the respondents Kos with the office in Pristina, now with unknown addresses and KS "Siguria" with the office in Pristina, grounds of the dispute: Debt, dated 06.05.2019 renders the following:

RULING

Lawyer Nexhat Sylva from Pristina is hereby appointed temporary representative of the first respondent Kos with the office in Pristina, currently with unknown address. The temporary representative shall have all the rights and duties of a legal representative to undertake until the appearance of the respondent or its duly authorized representative in the court, respectively until the custodian body appoints a custodian.

Reasoning

Since the communication with the respondent is not possible, having considered the acknowledgment receipt (where it is ascertained that the defendant's office is closed), and also from the notification of ARBK, it results that the address of the respondent is the same as the court has communicated so far, while the court is unable to reach the respondent, so that the parties would have consequences for the proceedings, the court has appointed a temporary representative of the first respondent. The temporary representative shall have all the rights and duties of a legal representative to undertake until the appearance of the respondent or its duly authorized representative in the court, respectively until the custodian body appoints a custodian. The court has made this decision applying Article 79.3 of LCP.

COMMERCIAL COURT IN PRISTINA
Department of Commercial Affairs
V.EK.No. 139/17 dale 06.05.2019

Judge:
Faton Bajrami
/Signed/


Legal remedy: No appeal is permitted to be filed against this ruling pursuant.

/Round stamp of Basic Court of Pristina/

